

*Dukagjini "Nderi i Kombit"*



*Dukagjini*

**Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXI i botimit, nr. 241, Nëntor 2023**

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: [www.shoqatadukagjini.com](http://www.shoqatadukagjini.com), Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro



**Gëzuar festat e Nëntorit të gjithë shqiptarëve, kudo ndodhen: Shqipëri, Kosovë, Mal të zi, Maqedoninë e Veriut, Greqi dhe diasporë.**

**Për shumë mot!**

# Inagurimi i restaurimit të kishës së Shën Gjon Kryepremi Mërqi - Lezhë

Pa hyrë në qytetin e Lezhës, me pikënisje nga Shkodra, në krahun e majtë, merr rruga që të çon në kishën e Kuvendit të Arberit, ose ndryshe kisha e Shën Gjon Kryepremi. Ajo ka një pozicion mjaft të bukur gjeografik, pasi sa më lart ngjitesh drejt saj, aq më shume pamja madhështore shtrihet para teje, deri ku deti bashkohet me qiellin dhe fushat e gjelbërta e konturojnë hijshëm.

Që nga porta hyrëse, lehtë identifikohet profili i vjetër i kishës, të një kohe të largët, por që kurrë nuk i humbi lidhjet me të tashmen, falë njerëzve vullnetmirë që ia rrëmbyen atë, pluhurit të harresës.

Ndoshta nuk kemi një datë fikse të ndërtimit të saj, por mund të themi, bazuar në shkrimet e studiuesve, se në këtë kishë, u mbajt një nga kuvendet e Arberit, për të cilin do të flasim në këtë reportazh.

Oborri, që pas restaurimit, rrethon hijshëm kishën, ende ruan qetësinë e një vendi lutjeje. Pranë kishës qëndrojnë edhe varret e fshatit Mërqi. Ai ka pranë fshatrat Raboshtë e Kallmet, pjesë të bashkisë së Lezhës.

Vizitorët e parë tashmë kanë mbërritur. Pikërisht në këtë kishë, në vitin 1703 u mbledh Kuvendi i Arberit për të mbrojtur gjuhën dhe kulturën shqipe nga asimilimi dhe zhdukja si shkak i pushtimit otoman.

Kisha në brendësinë e saj ka, dritaret vitratë të stilit klasik, me imazhe shenjtërisht mbrojtës të dioqezave pjesëmarrës në Kuvendin e Arbrit, nga Shkupi e Tivari e dioqezat në Shqipëri. Edhe një monument tjetër i rëndësishëm iu shtua Kishës së Shën Gjonit. Në oborrin e saj, një pllakë e madhe guri me simbolin e Kuvendit ku simbolizohet, pushteti i Papa Albanit dhe orenditë për Celebrimin e Meshës së Shenjte në kushtet e pushtimit otoman të trevave Arbënore.

Kisha arriti të qëndrojë e fortë në këmbë deri në vitin 1967. Por ky ishte viti famëkeq, kur sistemi i asaj kohe mbylli funksionimin e të gjitha kishave në vend.

Kishes iu rikthye frymëmarrja, edhe pse e sakatosur nga keqpërdorja, me rënien e socializmit dhe ndërrimit të sistemeve. Besimtarët ndër dekada, kanë ardhur këtu me vullnetin e mire e besimin tek Zoti, që diktatura nuk ua crrënjosi, por ata nuk e kanë ditur historinë e veërtetë dhe rolin që ka pasur kjo kishë në historinë kombëtare.

Sot, në festën e inagurimit të restaurimeve të kishës, kanë ardhur personalitete të larta të klerit katolik nga Shqipëria, Kosova, Mal I Zi dhe Kroacia: Imzot Angelo Massfra aripeshkëv metropolitan Shkodër – Pult, ipeshkëvi i Lezhës Ottavio Vitale, Mons. Dodë Gjergji ipeshkëv i Kosovës, Mons. Rrok Gjonllëshaj arqipeshkëv i Tivarit, Mons. Zef Gashi isharqipeshkëv i Tivarit, At Elton Margjeci famullitar i Kallmetit dhe Mërqisë etj. Po ashtu, nderuan me pjesëmarrjen e tyre Kryetari i Bashkisë Lezhë Pjerin Ndreu, Konsulli i Nderit të Austrisë Gjergj Leqejza, etj.

Dom-Nike Ukgjini studiues dhe orga-

nizator, mbartës i punimeve, falë këmbënguljes së këtij kleriku të nderuar u aarit kjo ditë. Dom Nika ka dhënë një kontribut të vyer në rimëkëmbjen e shumë kishave dhe dokumentimit të historisë së tyre.

Puna e filluar që në muajin Maj të vitit 2022, për rehabilitimin, restaurimin e kry-

Klementit (Albanit) e para shtatore e këtij Pape me origjinë Arbërore, u përmbush ëndrra shumë vjeçare e Dom Nikës, për rehabilitimin e këtij objekti kishtar, me karakter të fort historik e kombëtar, ku më 14-15 janar të vitit 1703, me urdhrin e Papa Albanit, delegati i tij Vinçenc Zma-

por edukuar në një familje me tradita nga Gimajt e Shalës së Dukagjinit, për të cilin ky investim vjen pas disa të tjerëve në vendlindjen e tij. Iliri, edhe pse i ri në moshë, ka ngitur shoqatën “Bajraktari” në NY, në 15 janar 2020. Së pari ai organizoi ndërtimin e kompanjelit dhe restaurimin e plotë të Kishës Gimaj, rrugën e re shkëmbore e ujësjellësin e ri për tek Kisha, reabilitimin e rrugës nga Kisha - Ura Gimaj - lumi i Shalës, si dhe urën e re në Xhaferaj e cila lidh Gimaj - NënMavriç - Breg Lumi. Një tjetër vepër është ujësjellësi i ri 1400 m brenda në Gimaj, Radojë - Gimaj si dhe rezervuari i ri, pastrimi i malit për hapjen e rrugës për tensionin e lartë 1.000 vatësh, kabinë elektrike me transformator në shtyllë, si dhe ndihma për disa rikonstrukcione shtëpish. Por jo vetëm kaq për atletin nga Gimajt, kryetarin e kësaj shoqate amerikano - dukagjinase; donator në objekte si; Truporja e Shna Ndout ne Breg Lumi, ura e telit, afër ish repartit ushtarak, e deri në riparimin e rrugëve të tjera në Dukagjin.

Kësaj rradhe biri i Gimajve të Shalës, zgjodhi të financonte shtatoren e Papa Klementit të XI. Anash saj lexojmë shprehjen “Më shkrueni në vorr që rrjedh prej gjakut arbnor”. Gjon Francesk Albani 1649-1721....

Në kishë po bëhen përgatitjet e fundit para nisjes së ceremonisë së inagurimit dhe shfaqjes artistike që do jepet në fund të saj, për t'i dhënë ngjyra festive aktivitetit.

Pas bekimit qe Ipeshkëvi i Dioqezes së Lezhës, Ottavio Vitali, i bëri kishës, personalitetet klerike mbajtën fjalët e rastit duke vlerësuar punën e bërë dhe rëndësinë që marrin kisha të tilla, tek të cilat kanë ndodhur ngjarje të mëdha kombëtare, për të dëshmuar rrënjët tona shqiptare.

Një moment mjaft emocionues ishte kur të gjithë të pranishmit në këmbë kënduan me shpirt vargjet e Patër Gjergj Fish-tës, “Bini gegë e bini toskë”. Më tej një program artistik u mirëprit nga besimtarët, ku interpretimet në instruemnte, apo dhe vargje, këngët patriotike por dhe ato me motiv kishtar, përcollën një atmosferë vërtetë festive.

Duket sikur edhe pas aktivitetit të organizuar nën kujdesin e Dom Nikë Ukgjinit, kisha po i mban ende pranë besimtarët e saj. Ata zgjedhin të qëndrojnë edhe pak. Në ditët në vijim, ndryshimet e bëra këtu, do ta kthejnë këtë kishë në një vend peligrinazhi, pse jo, edhe në vendin e mjetjes së mjaft aktiviteteve me karakter historik e kulturor. Tashmë ajo nuk i pëkret vetëm banorëve të fshatrave rrotull, por gjithë Shqipërisë.

Nëse tashmë një dëshmi e fortë e rrënjëve shqiptare u zbulua nga pluhuri i kohës, janë me dhjetra vende të tjera historike, që presin rolin e shtetit në rimëkëmbjen e tyre dhe shpëtimin nga harresa.

**KOZETA BRUÇI,**  
Shkodër, më 20.11.23



Kisha e Shën Gjon Kryepremi, në Mërqi



Shtatorja e Papa Klementi XI



Monsinjor Angelo Massafro, me djalin nga Gimajt e Shals, Ilir Bigaj

erjen e disa punimeve shtesë në Kishën e Kuvendit të Arbrit dhe ambientin për rreth, kulmoi me bekimin e shtatores prej guri të Papa Klementit XI, Albanit, shtatores pikërisht në vendin ku u mbajt 320 vite më parë Kuvendi i Arbrit. Qenësia e papa Albanit pas 302, viteve të kalimit në amshim, në këtë formë u kthye në tokën amë. Me vendosjen e shtatores së Papa

jevichu, duke i bashkuar të gjithë ipeshkviçjtë e trevave Arbërore, mbajtiti Kuvendin e Arbrit.

Restaurimet kërkonin fonde, dhe për këtë ka shërbyer bashkëpunimi i Dom Nikë Ukgjinit me diasporën. Njëri prej investitorëve në këtë kishë është edhe Ilir Vat Biga, 27 vjecar, i lindur në NY të USA,



Grupi artistik

# Përrurohen punimet në Kishën e Kuvendit të Arbërit në Lezhës nën përkujdesjen e Dom Nikë Ukgjinit



Nga Frank Shkreli,  
Ish-Drejtor i VOA-s për Euro-Azinë\*

Sipas nismëtarit të këtij projekti të madh, por edhe shumë të tjerave në ato anë, Dom Nikë Ukgjinit dhe bazuar në informacion nga rrjetet sociale, të shtunën me 18 nëntor, 2023 në Mërci të Lezhës u zhvillua ceremonia e përrurimit të punimeve në Kishën e Kuvendit të Arbërit. Ky Kuvend Kishtar Arbëror është mbajtur aty me 14 e 15 janar, 1703, i organizuar me porosinë nga Papa shqiptar, Klementi i XI – Albani.



“Populli em u ba rob, se nuk pat dien”

Nën përkujdesjen e të palodhshmit Dom Nikë Ukgjinit, të shtunën u zhvillua ceremonia e përrurimit të punimeve përfundimtare në Kishën e Shën Gjonit ku 320-vite më parë është mbajtur Kuvendi Arbërit në Mërci të Lezhës; punime të cilat kanë filluar kohë më parë për rehabilitimin e kësaj kishe historike dhe me vlera të mëdha fetare e kombëtare për të gjithë shqiptarët pa dallim – të rëndësishme për mbrojtjen e identitetit kombëtar dhe ruajtjen e gjuhës shqipe. Frank Shkreli: Kanë filluar punimet për rehabilitimin e Kishës së Kuvendit të Arbërit afër Lezhës | Gazeta Telegraf.

Përrurimi i punimeve të shtunën që kaloi në Kishën e Shën Gjonit – Kishën e Kuvendit të Arbërit, është një tjetër projekt i përfunduar në rrethin e Lezhës, nën përkujdesjen e Dom Nikë Ukgjinit. Në ceremoninë e përrurimit morën pjesë personalitete kishtarë dhe vendore nga Shqipëria, Kosova, por edhe nga vende të largëta si Dalmacia, Kroacia, Bosnja e Mali i Zi. Nga trojet shqiptare dalloheshin, ndër pjesëmarrësit në këtë aktivitet, Arkipeshkvi i Shkodrës, Angjelo Massafra, Ipeshkvi i Kosovës, Dodë Gjergji, Ipeshkvi i Tivarit, Rrok Gjonlleshaj, Ipeshkvi i Lezhës, Ottavio Vitale, si dhe Kryetari i Bashkisë Lezhë, Pjerin Ndreu, klerikë, intelektualë e historianë nga Shqipëria e Kosova. Pjesëmarrësit që folën me këtë rast, me të drejtë, vlerësuan lart punën dhe mundin e Dom Nikë Ukgjinit, jo vetëm për real-

izimin e këtij projekti, por edhe shumë të tjerëve, në përpjekjet e tij të vazhdueshme për të ruajtur dhe mbrojtur atë trashëgimi qindra-vjeçare fetaro-kombëtare, që ende mund të shpëtohet nga shkatërrimi prej njerëzve dhe prej natyre.

Dom Nikë Ukgjini nismëtar dhe organizatori i rinovimit dhe punimeve në Kishën historike katolike të Shën Gjonit afër Lezhës ku është mbajtur Kuvendi i Arbërit (320-vjetë më parë – janar 1703) nën përkujdesjen e Papës me origjinë shqiptare, Klementit të XI Albani.

Realizimi i këtij projekti; përrurimi i punimeve të shtunën i këtij monumenti të rëndësishëm për identitetin, gjuhën dhe kulturën shqiptare është meritë e Dom Nikë Ukgjinit me disa bashkpunorë të tij të ngushtë e që kanë vazhduar ta mbështesin me mundësitë e tyre, në ringritjen e këtyre objekteve kulturoro-fetare në atë zone, të cilat janë dëshmi e gjallë e vazhdimësisë së identitetit kombëtar e fetar të shqiptarëve në ato anë, prej shekujsh. Objekte këto, të cilat, ishin lënë pas dore nga ish-regjimi komunist bazuar në ideologjinë e tij anti-fetare dhe anti-kombëtare, por edhe nga qeveritë post-komuniste të 30-viteve të fundit, objekte të harruara dhe lënë në mëshirë të fatit; një praktikë kjo anti-kombëtare që vazhdon edhe sot e kësaj dite dhe që po kontribon në zhdukjen e trashëgimisë kulturore të mbi-dheshme dhe nën-dheshme, si dhe identitetit historik kombëtar të shqiptarëve në ato anë. Por falënderës Zotit për shqiptarë të mirë e të palodhshëm, patriotë si Dom Nikë Ukgjini me bashkpunorët e tij, i cili po mundohet të shpëtojë atë që mund të shpëtohet me mjetet e tyre të kufizuara materiale e financiare për rehabilitimin dhe ruajtjen e këtyre vendeve të shënjta, me rëndësi për historinë e asaj zone dhe mbarë trojeve shqiptare në Ballkanin Perëndimor. Duhet t'i jemi mirënjohës Dom Nikës dhe të gjithë atyre mbështetësve të tij, si Gjergj Leqejza, Viktor Jushi e të tjerë, që sipas të dhënave, i janë bashkuar Dom Nikës në këtë mision të shënjtë me vlerë historike, fetare e kombëtare.

Pak të dhëna për të venë në njëfarë perspektive historike rëndësinë, që kishte në atë kohë mbajtja e Kuvendit të Arbërit dhe për rëndësinë e trashëgimisë identitare fetare dhe kombëtare që ka ose që duhet të ketë sot për të gjithë shqiptarët pa dallim. Në një artikull botuar nga Radio Vatikan me 14 janar, 2019 flitet për kushtet dhe rrethanat shumë të vështira nën të cilat është mbledhur Kuvendi apo Koncili i Kishës Katolike i trojeve shqiptare në atë kohë – përballë sfidave dhe problemeve të mëdha që perandoria osmane kishte imponuar mbi jetën dhe veprimtarinë e Kishës Katolike shqiptare, 320-vjetë më parë. Kuvendi Kishtar i Arbërit u mor me të gjitha ato probleme të rënda që përjetonte çdo ditë fisi i shqiptarit, e sidomos përballimi me rrezikun e humbjes së identitetit kombëtar dhe zhdukjen e gjuhës shqipe dhe të drejtave fetare. Kuvendi kishtar i Arbërit dhe mbrojtja e identitetit kombëtar e fetar të shqiptarëve – Vatican News.

Si rrjedhim, përveç gjendjes së mje-



ruar fetare në viset e Arbërisë, Kuvendi Kishtar i Arbërit i vitit 1703, ka shqyrtuar,

ndër të tjera, sipas atij artikulli, kufizimet e rënda të imponuara nga okupimi Osman mbi shqiptarët e që kërcënonin seriozisht identitetin kombëtar dhe fetar të shqiptarëve: dy çështje këto me rëndësi e që u mbrojtën si jetike për mbijetesën e shqiptarëve si Komb me identitetin e tij të veçantë kombëtar e fetar. I një rëndësie të veçantë historike, sipas historianëve dhe gjuhëtarëve është botimi në gjuhën shqipe i punimeve të Kuvendit të Arbërit, që konsiderohet si i pari botim shqip, të pakën deri tani i akteve kishtarë sinodale në gjuhën shqipe nga një takim i atij niveli të lartë, 320-vjet më parë, sipas artikullit në fjalë.

Shkrimtari e studiuesi Tonin Çobani në një vlerësim të librit të shkrimtarit e historianit të ndjerë nga Kosova, Engjëll Sedaj: “Papa shqiptar Klementi XI-Albani & Kuvendi i Arbërit”, botuar më 1998 nga Ndërmarrja botuese “Gjon Buzuku”, citon autorin Sedajn të ketë shkruar në librin e tij se Kuvendi i Arbërit është një “Kujtesë e dokumentuar dhe e pashlyeshme e historisë së popullit shqiptar në dimensionet më të gjera të jetës së tij.”

Urime Dom Nikë Ukgjinit dhe të gjithë atyre që e mbështetën atë në këtë përpjekje të suksesshme që me mund e mbështetje të mëdha financiare, fizike e mendore, më në fund ia dolën: që me ceremoninë e përrurimit të punimeve në Kishën e Kuvendit të Arbërit, të shtunën që kaloi, Dom Nika me bashkpunorët e vet, përjetësuan këtë, “Kujtesë të dokumentuar dhe të pashlyeshme të historisë së popullit shqiptar në dimensionet më të gjera të jetës së tij”, duke e kthyer këtë Monument të historisë së Kombit shqiptar; Kishën e Kuvendit të Arbërit në identitetin e saj origjinal, duke ndriçuar kështu sadopak errësirën shekullore të historisë së kaluar të Kombit shqiptar, jo vetëm për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm të shqiptarëve, por edhe për të huajt.

Nga Gazeta Telegraf,  
me 21 Nëntor, 2023



# Fjala Përshëndetëse, dom Nikë Ukgjinit, me rastin e inaugurimit të Kishës restauruar në Mërqi të Lezhës



Të nderuar shkëlqesi autoritete kishtarë, nga Shqipëria, Mali i Zi e Kosova, autoritete të qeverisjes lokale, studiues të punës artistike, donator të ndryshëm nga brenda dhe jashtë, dhe dashamires të këtij kremtimi!

Pasi takimit shkencor të mbajtur dje në Kotorr të Malit të Zi, për kontributin e arqipeshkvinjve të Tivarit, Andria e Vicko Zmajeviq, sot ne gjendemi në Kishën legjendare të Shën Gjonit, e cila para 320 viteve më datën 14 -15 janar 1703, mikpritit barinj të shpirtërore nga të gjitha trevat arbërore të mbledhur për të kuvendua për fatin e mëtejshëm të shqiptareve të cilëve ju rrezikohej së tepërmi, ekzistenca nga dhuna e egër osmane.

Ishte imzot Vicko Zmajeviq arqipeshkëv i Tivarit, kur papa Klementi XI Albani, nga i cili gufonte gjaku arbërorë i urdhëroj të besuarit e tij, që në emrin e Kishës së përbotshme, ti bej tok arbërorët, që të kujdesën me të gjitha forcat për ringjalljen e jetës fetare të popullit, e të puno-

jnë për ripërtëritjen, rritjen e klerit, për lirinë fetare e të popullit dhe hapjen pranë kishave sa më shumë të shkollave shqipe.

Në Aktet të Kuvendit të Arbnit, të cilat u botuan në latinisht e shqip në vitin 1706, nga Imzot Zmajeviq, fton klerin katolik shqiptar, përkundrejt torturave nga pushtuesit, të qëndroi pranë në gazmende e në vaj pran popullit të vet, si një investim i duhur dhe një paraprije e rilindjes sonë kombëtare.

Më ardhjen e demokracisë në mars të viti 1991, Kisha katolike si pjesë e këtyre vuajtjeve të këtij populli, me këtë rast filloj edhe ajo ringjalljen e saj. Meshtarët përpos punës intensive baritore, ju desh të rrënuara të disa objekteve të kultit. Kështu ndodhi edhe me Kishën legjendare të Kuvendit të Arbnit, e cila gjatë kohës se komunizmit kishte degraduar se tepërmi.

Prandaj duke u parë të nevojshme ndërhyrjet: u bë restaurimi dhe ndërtimi i murit ballor, atij fundor dhe çatisë, në vitin 1996, falë për kujdesit të famullitarit të atëhershëm të kësaj zone, dom Dodë Gjergjit, i cili do shprehej se: unë e bana punën teme, por do vij koha kur prape do

vihet dore mbi këtë objekt për rikthimin në identitet sa ma të sakte fillestar.

Sot i gëzohemi frytit të një pune shumë të lodhshme, pothuajse dy vjeçare e filluar në prill 2022, me meremetime, ndërtime, sistemimin e brendshëm të kishës dhe ambientit të jashtëm të saj.

Ky ambient ka filluar vlerën e dyfishte me vendosjen e dy figurave qendrore të organizimit të këtij Kuvendit Arbëror, Papa Klementit XI Albani dhe Vinçenc Zmajeviq, të cilat janë përjetësuar në shtatore guri, në shenjë kujtese e frymëzimi për brezat e rinj. Ngritja e shtatores së Vicko Zmajeviq është një rast i mire, për krijimin e lidhjeve të binjakëzimit të Perastit me famullin e Mërqi.

Duke qenë të bindur se kemi bërë një punë të vlefshme për ungjillëzimin kulturorë dhe shtuar një vlerë të madhe në trashëgimin tonë Kulturore Kombëtare, dëshiroj të falënderoj ipeshkvin e Lezhës, Mons. Ottavio Vitale, për bashkëpunim; Krypepshkvinë timë të Shkodrës, Mons. Angelo Massafra për mirëkuptim e dhënien e kohës së lirë; Bashkinë e Lezhës për kontributin e dhënë në ndërtimin rrugës dhe punimeve të tjera; kontribuue-

sin e mikun e kulturës afaristin Gjergj Leqejza dhe donatore të tjera nga vendi dhe nga jashtë vendit, si Amerika e Zvicra, të cilët janë prezent me delegacionet e tyre.

Me këtë rast do veçoja donatore të shtatoreve, Ilir Vatë Bigën për ndërtimin e shtatores të Papa Albanit i cili ka ardhur veçmas prej New Yorkut, dhe dioqezat: Tivarit, Kotorrit, Zarës dhe Nikollë Shabani për shtatoren e Zmajeviqit.

E kjo punë e bukur për sy e për vesh nuk do ishte realizuar me suksese pa ndihmën grupit studimore e artistik.

Grupi i punës: ark, Aleksander Jushi më familje; inxh. Sokol Gazulli; skulptor Sadik Spahia; piktur Vasil Diamanti e konsultoreve të tjerë të heshtur. Me këtë rast do veçoja edhe skulptorin e rij, Ervis Gjini – Kovaçi, i cili dhuroj dhe realizoj simbolin madhështor të Kuvendit të Arbnit të vendosur në oborrin e kësaj Kishë.

Do përfundoja me parafrazimin e fjalëve të ungjillit; Sa është mirë kur vëllezërit jetojnë e punojnë së bashku.

Faleminderit!

**Mërqi, 18 Nëntor 2023**

## FESTA E GESHTENJËS

Për të 4-in vit radhazi Njësia Administrative e Shllakut feston festën e Gështenjës. Kjo festë merr një vlerë tepër të veçantë këtë vit, pasi organizimi i saj është bërë nga banorët e krahinës, por me mbështetjen e kryetarit të bashkisë së Vau Dejës, z. Kristjan Shkreli, i cili tha se do të lloboje tek qeveria për rikonstrukcionin e plote të rrugës së Shllakut.

Një rol tepër kryesor në këtë festë kishte edhe famullia e Shllakut, famulltari Dom Marjan Gjinesha, i cili në fjalën e tij theksoj, se kjo festë kontribuon në transmetimin e vlerave të këtij vendi.

Festa e Gështenjës në Shllak, në kodër Ukbibaj, është kthyer tashme në një tradite e iniciuar nga Mark Gjeka, i cili ka mbi 3 vite, që po e promovon këtë zonë në rrjetet sociale.

Atmosferën u zbukurua ende më

shumë me vallet e të rinjtë e famullisë së Shllakut. Banoret dhe miqtë, pjesëmarrësit në tërësi shijuan gatimet tradicionale të krahinës, dhe sidomos gështenjat.

### SHLLAKU E KTHEN NË TRADITË FESTËN E "GËSHTENJËS"

Shllaku i historisë, i kulturës dhe traditës, Shllaku i burrave trima dhe intelektual, që Shkodrën e kishte larg vetëm një vrap kalit, Shllaku që kurr nuk pati ujë, sot ka pak banorë, por në Festën e Gështenjave mirpiti për të katërti vit me radhë qindra miq nga krejt Trojet Shqipëtare. Kjo festë që është kthyer tradicionale fale kontributit të grupit organizativ. Një organizimin i shkëlqyer nga z. Mark Gjeka publicist dhe promovues aktiv i vendlinjes të tij. Nuk mungoj mbështetja dhe prania kryetarit të Bashkisë Vau Dejës z. Krist-



jan Shkreli, një djalë puntor, i thjeshtë dhe i kulturuar. Si gjithmonë famulltari i zonës Dom Marjan Gjinesha, ishte aktiv dhe kontribues në mbarvajtjen e festës. Banore të zonës të ardhur nga larg kudo që banojnë, vijne çdo vit sepse i thërret zeri i vendlinjes.

Grupi artistik i krahinës, grupi i valleve me kostume tradicionale, por edhe këngëtar të ftuar nga Malsia e Madhe dhe Dukagjini.

Kjo festë e moderuar si gjithmone nga gazetarja Kozeta Bruçi, që gjendet kudo ka veprimtari krijuan atmosfere festive për të gjithë.

Shoqata Atdhetare "Dukagjini" dhe disa miq të tjere jemi pasionant, por edhe miq të respektuar në festën e Gështenjave

Shllak. Komandanti ynë zoti Ndue Sanaj, shkrimtari z. Prelë Milani, Intelektuali i nderuar z. Mhill Shkëmbi, miku im Ridvan Garuci, z. Sokol Kroni, z. Nikolle Pjetri dhe poeti Kolë Kodra shijuan nje dite të bukur. Nën rrezet e një dielli të pazakonte për kohën, me verë, raki dhe thalba gështenja, ashtu si në shumë grupe familjare dhe shoqerore e shijuan Festën e "Gështenjës Shllak-2023".

Respekt për organizimin tuaj, mikpritjen dhe traditën e bukur që keni krijuar, ky vend ka nevojë për shembuj pozitiv, për inisiativa novative ka nevojë për djem të thjeshtë dhe punëtor.

**LULASH BRIGJA,  
26 tetor, Shllak 2023**



# Gjuha shqipe është, sot e mot, pasuri kombëtare bazë



Fran GJOKA

Gjuha përbën elementin (komponentin) kryesor të kulturës në planin sociologjik. Në këtë kuptim eliminimi i gjuhës çon në eliminimin e një kombi. Aq më tepër kjo përbën rrezik për popujt e vegjël që historia për arsye ekonomike politike e sociale i ka shpërndarë anë e kënd botës. Nuk bën përjashtim në këtë mes as Shqipëria pushtimi i vazhdueshëm i së cilës nga fuqitë e mëdha ka pasur ndër të tjera, synimin e të mos folurit dhe të mos shkruarit të gjuhës shqipe dhe as të hapjes e të funksionimit të shkollave është një histori tashmë e provuar ndër shekuj mbi shkronjat dhe analfabetin tonë. Kjo është aq e vërtetë sa po të mos ishte këmbëngulja e përpjekjet maksimale, vërtetësia dhe mençuria, zgjuarsia intelektuale dhe patriotizmi i rilindësve tanë të mëdhenj e shoqëruar edhe me mbështetjen e popullit tonë trim e arsimdashës, gjuha e bukur dhe e pasur shqipe në mos do të ishte asimiluar së paku do të ishte sakatuar. Nuk mund të lihen jashtë vëmendjes as roli i klerit në tërësi e veçanërisht i atij Katolik në vendin tonë, para së gjithash në Shqipërinë e veriut, në ruajtjen nga ndikimet e huazimet e huaja, të cilat shkallë-shkallë do të copëtonin e shkatërronin gjuhën tonë deri në atë masë sa në Shqipëri mund të shkohej deri në të folurit e një sllavishteje të gjymtuar ose të një turqishteje të çalë. Ja pse ne kemi respekt të veçantë për De Radën, frashëllinjët, At Shtjefën Gjeçovin e Negovanin për Fishtën e madh e dhjetëra rilindës fetarë në besim, por kombëtar të mëdhenj, aq sa për shkronjat e të shkruarit dhe të folurit shqip sakrifikuam çdo gjë, edhe jetën e tyre, në këtë kuptim dhe me këtë vlerësim ne u jemi atyre mirënjohës për çdo gjë që bën për të ruajtur gjuhën shqipe dhe për ta pasuruar atë.

Sot, ne kemi një gjuhë letrare shqipe të njehsuar, të ndërtuar mbi bazën e vlerave më të mira të dialekteve kryesore, për të cilën ka rezerva e njëanshmëri në trajtimin e saj, të miratuara këto nga studiues të bunkerizuar mendërisht e politikisht, që parapëlqejnë krahinizat dhe që përfaqësojnë grupe sociale nga më të ndryshme. Që gjithsesi besojnë se teoritë e tyre për nevojën e besimit në të folur dhe në të shkruar nuk do të ngjasi asnjëherë pasi ajo ka marrë fund tashmë konfirmimin institucional të gjuhëtarëve më të aftë të Shqipërisë dhe të trevave ku banojnë

shqiptarët. Si kokat gjeniale të gjuhësisë e të shkencës shqiptare si Mahir Domi, Eqerem Çabej, Idriz Ajeti, Aleks Buda, Androkoli Kostollari, Dhimiter Shuteriqi, Ismail Kadare, Jakov Xoxe, Lasgush Poradeci, Sterio Spase, Jup Kastrati, Gjovalin Shkurtaç, Xhevat Lloshi, ndaj kushdo që bën përpjekje t'u kundërvihet këtyre ideatorëve të gjuhësisë janë të destinuar të dështojnë gjithnjë ndaj me plot gojë do thosha se gjuha shqipe është pronë e popullit dhe nuk pranon etiketime që bien ndesh me këta gjigandë të gjuhësisë shqiptare. Duke mbajtur këtë parim, ne nuk jemi nacionalist në ruajtjen dhe në transmetimin e traditës, të normave e të vlerave kulturore, simboleve dhe kulturës materiale duke përfshirë gjuhën tek brezat pasardhës çka duhet përgëzuar e përshëndetur shqiptarët e Kosovës, Malit të zi, Maqedonisë së Veriut disa vende të Evropës dhe të Amerikës. Ndryshe ndodh shqetësimi tek qindra fëmijë emigrantë shqiptarë tek flasin në shtëpitë e tyre greqisht, anglisht, italisht e ku ta dimë se ç'gjuhë tjetër por vetëm shqip jo. Jo vetëm shteti dhe institucionet e tij kanë për këtë përgjegjësi, por edhe familjet e tyre që siç duket disa prej tyre, e kanë ndoshta për turp deklarohen se janë shqiptarë.

Lidhur me procesin e gjatë dhe objektiv të rritjes së kulturës gjuhësore të

delikate dhe më të mprehta zënë fill që te interesimi i fëmijëve e të rinjve në shkolla e fakultete. Duhet të tregohemi vërtet të kujdesshëm për të njohur mirë pasurinë gjuhësore në të cilën ata nisin shkollën. Vetëm kështu, mësues e nxënës, mund të përshkrijnë së bashku udhën drejt gjuhës amtare dhe drejt gjuhëve të mëdha të kulturës evropiane.

Libri i prof. dok. Gj. Shkurtaç "Si të shkruajmë shqip" është një pasuri tjetër në fondin e veprimtarisë së tij dhe një apel për mësuesin shqiptarë në përgjithësi e administratën publike dhe jo publike në veçanti. Pra, ka ardhur koha për ndjenjë e pasion, dashuri të lartë e, mbi të gjitha, respekt dhe vlera të mëdha për këtë thesar, ndër të parës dëshmuar të dallimit kombëtar. E parë nga këta faktorë, të cilët duhet të njihen mirë, nga se kjo fushë e dijës është shenjë e parë dalluese e veçantisë kombëtare, brezat e sotëm dhe ato që do të vinë të dinë se kemi kapërcyer shumë shekuj përpjekje të këtij kombi, për ti vënë këto në themelet e duhura e të shëndosha, të cilat qëndrojnë në ditët e sotme. Po për këto piketa ndërtime, është derdhur shumë gjak dhe është paguar shumë shtrënjtë gjuhësia shqiptare si Petro Nini e Dhaskal Todri, gjithnjë kujtojmë me respekt të veçantë e me plot dinjitet e gjithnjë frymëzues për brezat si pjesëmarrës të

dy vëllezërit, Naimi dhe Samiu. Edhe Noli, me urtësinë që e karakterizonte për vlerat njohëse të gjuhës e të kombit, pati thënë: "Lëvizja për të ngritur gjuhën shqipe në shkallë kombëtare nisi në Toskëri. (shih F. Agalliu, në "Gjuhën e Nolit", Tiranë 1999). Këta dy dijetarë të mëdhenj, Xhuvani që i takonte të folurës veriore, ndërsa Noli i përkiste të folurës jugore, nuk vuanin nga bajraktarizmi as nga fise e klane shqiptare, të cilët i kapërcyen për tu mbajtur kombi i patundur vetëm në saje të gjuhës së njësuar, për të cilën ballafaqohemi sot, aty këtu, edhe me telashe dhe shpeshherë edhe me synime ndarëse. Duke lexuar mediat e sotme, njeriut të ndershëm i bëhet sikur gjuha e sotme letrare standarde, e përcaktuar 48-vjet më parë, ka mbetur vetëm në letër, nuk ka arritur përgjegjshmëri ligjore dhe penalizuese, siç duhej të ishte. Ky shqetësim duhet të shoqërohet gjithnjë me një propagandë dinamike, ku vetë gjuha amtare të vlerësohet me maksimumin e kërkuar, e studimet mbi shqipen letrare të zënë vendin e merituar.

Si ja bëri Naimi i madh që si gjënë dot asnjë barbarizëm në veprën e vet? Po Noli, që mori guximin dhe solli në shqip Servantesin, Shekspirin dhe Khajjanin? Po Konica, Kuteli, Poradeci, Xoxe, Agolli, Kadareja e plot të tjerë? Këta mjeshtra të fjalës, e gjetën të pa tharur arën e fjalës, ama fjala u ndrit në fjalë, prozë e poezi. Shëndoshja e mbrojtja e gjuhës standarde mund të bëhet me masa të prekshme energjike prej mendjesh që mendojnë tamam shqip e prej zemrave që rrahin shqip. Gjuhën shqipe e kemi ndër më të vjetrat e më të mëdhatë e kontinentit, për të mos e rendit ndër dhjetë gjuhët më të rëndësishme të rruzullit. Gjuhën tone të bukur shqipe e kanë vlerësuar gjithnjë edhe personalitete të huaja, për lashtësinë, forcën shprehëse që ka. Një nga personalitete e mëdha të historisë si Napolon Bonopardi është shprehur kështu: "Kur flas me gra më pëlqen të flas frëngjisht, kur flas me burrat e mijë, më pëlqen të flas shqip!" Kam rastisur të lexoj diku se si presidenti i asaj kohe të Greqisë, Pavllo Kullurioti me origjinë Arvanitas, që shumicën e urdhëresave shtetërore i nxirrte në gjuhën shqipe. Ndërsa filozofi dhe shkencëtari I shquar Godfrid. V. Lajbnici thoshte: "Me jepni një pale shkronjëza të mira, e t'u jap një gjuhë të mirë, më jepni një gjuhë të mire që t'u jap një civilizim fort të mirë". Shkurt, kur respekton gjuhën e folur dhe të shkruar, ke respektuar popullin tënd dhe traditën e tij. Gjuha shqipe është, sot e mot, pasuri kombëtare bazë. Vetë proceset e hapjes, bashkëpunimit dhe të integritimit rajonale ndërkombëtare, detyrimisht i japin mundësi edhe shqipes së folur dhe të shkruar të ecë natyrshëm në zhvillimin e pasurimin e saj me simotrat e shumë vendeve të BE.

Është fatalitet për ato vende me popullsi të vogël si Shqipëria, të shoqëruarit



një kombi, A. Xhuvani, që në vitet 50-të të shekullit të kaluar shkruante: "Solocizmat janë gabime të pafalshme, të cilave duhet tu reshtemi aq sa edhe gabimeve të tjera. Për këtë duhet një studim i thellë dhe i plotë i gramatikës së përdorimeve ... duhet të ndiqet edhe përdorimi i gjallë i popullit, edhe autoriteti i shkëmbimeve klasik. Ta kufizosh gjuhën në një cak të ngushtë shkrimi, kjo veç që e bënë gjuhën të lidhshme dhe pedentare, po është edhe një punë kundër natyrës së saj, pasi gjuha hynë në ligjet e evolucionit e nuk mund të shkarkohet pas dëshirës së një pale".

Evropa e ka ndërruar me kohë formulën e didaktikës së gjuhës, duke përcaktuar drejtime te reja në fushën e emancipimit gjuhësorë.

Kanë kaluar më shumë se një shekull dhe sot, në punët e gjuhës, problemet me

Kongresit të Manastirit si Fishta e Mit'hat Frasheri, Ndre Mjeden dhe Parashqevi Qirjazi, Bejo Topullin e Shahin Kolonjen.

Më shumë se njëqind vjet më parë, Xhuvani, hapur thoshte për daljen në dritë të një gjuhe letrare të njësuar, pra të krijuara mbi baza të shëndosha letrare. Ai mbetet burrë i madhe me zë e me name në fushën e dijës gjuhësore. Por puna e këtij dhe shumë xhuvanëve të tjerë të gjuhësisë të sotme shqiptare, që i kanë dhënë dhe i japin kombit në fushën e dijës dhe të urtësisë për çdo lami dhe këshillat e tyre nuk janë të kapshme e të rrokshme tek disa intelektual, mësues dhe punonjës të mediave të shkruara, të cilët po i fusin brirët gjuhës së sotme të njësuar.

Prof. Xhuvanit nuk i vinte fare rëndë që ti shtrijë dorën për punën e madhe që kishin bërë ne gjuhë dhe për gjuhën

me rrezikun e depërtimit dhe përdorimit, vend e pa vend, të huazimeve në dëm të fondit autokton, duke kaluar shpesh në varfërimin e gjuhës letrare kombëtare. Këto marrëzi, që më mirë i njeh publiku, na shiten si gjetje gjuhësore moderne (!), ky është një agresivitet i hapur gjuhësor. Është koha të pranojmë dhe të përipiqemi për të vënë nën kontroll, duke ngritur barriera, miratuar ligje dhe ngritur struktura të posaçme, për ta mbajtur të pastër shqipen, që është pasuria më e madhe dhe e patjetërsueshme me të cilën krenohemi.

Vërtetë jetojmë në një shoqëri të lirë e të hapur, vërtetë jemi përkrahës të globalizmit, por nuk do të dëshironim kurrë që gjuha jonë të mos shkruhej e të përdorej nga shqiptarët e të gjithë brezave. Mundësitë për ta mbajtur të gjallë gjuhën e bukur shqipe tek fëmijët, nipërit e mbesat dhe stërnipërit tanë, pavarësisht kur lindin dhe ekzistojnë, i mundëson shkolla që është institucioni bazë i mësimdhënies së gjuhës letrare dhe detyrë parësore ka të mësuarit e saj, e që sjell si rezultat aftësimin e fëmijëve dhe të rinjve për ta komunikuar e shkruar me frytshmëri atë.

Për shqiptarët emigrues, më gjithë përpjekjet e ruajtjes së saj, shqipja po bëhet sa e largët dhe e huaj për fëmijët mërgimtar. Është normale që, duke jetuar në një shoqëri ku flitet e shkruhet një gjuhë tjetër, kuptohet dhe tendenca e kufizimit dhe e shqiptimit të shqipes. Fëmijët po projektajnë të ardhmen e tyre aty ku rriten. Pra emigrimi në përgjithësi dhe ai i fëmijëve në veçanti, krahas të mirave, mbart me vete edhe rrezikun e një asimilimi gradual të gjuhës, sidomos tek fëmijët shqiptar që


jetojnë e mësojnë aktualisht në emigrim.

Faktet ekzistuese të një kombi përcaktohen, në fund të fundit, nga gjuha. Popullsia e një vendi që për arsye të ndryshme nuk e shkruan dhe rrallë herë nuk e flet gjuhën e vet amtare, është e prirur të rrezikohet, pasi gjuha ka qenë e mbetet një ndër komponentët kryesorë të kulturës së një kombi. Kur njeriu nuk e ka nën këmbë tokën e vet, humbet diçka nga qëndrimi vertikal, humbet sigurinë e bëhet më skeptik ndaj vetvetes.

Gjuha shqipe ka një zhërvjellësi në të folur, është shumë burrërore dhe mjaft e bukur, ka tingull të veçantë dhe mjaft impulsive. Shqipja është vazhdim i gjuhës ilire dhe i përket grupit të gjuhëve indo-evropiane, pra veçohet si një ndër më të vjetrat në Euroje dhe Ballkan. Këtu më vjen në mend një thënie e një mërgimtar: "Gjuha është e vetmja armë që vërteton se jemi shqiptar!"

Në Shqipëri dhe diasporë gjuhësia krahasimtare ka pasur arritje me vlera të mirëfillta shkencore dhe gjithnjë gjuhëtarët tanë të nderuar hedhin dritë në raportet e shqipes me gjuhët e tjera. Studimi i shqipes, përveç interesit shkencor, është i lidhur ngushtë me interesat tona kombëtare. Qëndrojmë para një fakti shumë të bukur, shumë interesant, që jo vetëm gegërishtja, por edhe gjuha e diasporës, sidomos e arbëreshëve të Italisë, tek e cila, në mes shumë barba-

rizmave, gjenden thesare të vërtetë, janë format më të vjetra të shqipes. Këtu kujtojmë përpjekjet pesëdhjetëvjeçarë të Prof. Shkurtaj, si njeri i nderuar, pasionant, intelektual me interes të paparë shkencor, studiues dhe hulumtues i gjuhësisë



shqiptare në tërësi dhe arbëreshëve të Italisë në veçanti. Kanë kaluar 111 vjet të Pavarësisë Kombëtare, realiteti i shoqërisë shqiptare ka fituar qytetarinë në fushën e gjuhësisë. Ajo ka gurgulluar dhe sjell ujëra nga lashtësia e shekujve, ku shqipja ka plazmuar mendimin, ka marrë forma të

personaliteteve që nga mendimi i Naimit, Çajupit, Fishtës, Mjedës, Konicës, Nolit, Migjenit, Poradecit e deri tek ai i Qoses, Agolli e Kadesës, Xoxe e Spase e të tjerë. Indiferentët dhe dembelët dhe ata që s'respektojnë parimet e gjuhës standarde shqipe, që nuk vazhdojnë rrugën e Rilindësve tanë, historia do ti dënojë, jeta përtej varrit do ti torturojë! Nga Bostoni i Amerikës, Konica shprehej: "Erdhi më në fund edhe për gjuhën shqipe koha e lulëzimit, kohë plot shpresë! Në të katër anët, një zjarr i bukur zien në zemër të djalërisë dhe, plot me dëshirë, trimoshët e dheut tonë po përipiqen për zbulimin e shqipes".

I vlerësojmë, i pranojmë dhe i respektojmë vlerat gjuhësore të popujve të tjerë. Dhe respekti për të tjerët ka vlerë e besueshmëri kur, në radhë të parë, respekton vlerat e kombit tënd!

Nga Bostoni i Amerikës Konica shprehej: "Erdhi më në fund dhe për gjuhën shqipe koha e lulëzimit, koha plot shpresë"! Në të katër anët, një zjarr i bukur zien në zemër të djalërisë, dhe plot me dëshirë,

trimoshat e dheut tonë po përipiqen për zbulimin e shqipes. I vlerësojmë, i pranojmë dhe i respektojmë vlerat e gjuhësore e kulturore të popujve të tjerë. Dhe respekti për të tjerët ka vlerë e besueshmëri kur në radhë të parë respektohen vlerat e kombit tënd...!

# GJURMË SHQIPTARE NË ALGJERI

(500 vjet më parë katër vëllezër ulqinak ndërtuan portin ushtarak të Algjerit)



Duke njohur nga afër historinë e gjatë të këtij qyteti bregdetar të Trojeve Shqiptare, ku çdo gjë lidhet me jetën e tyre me heroizmin si detar të guximshëm në shekuj, të këtij qyteti të bekuar me florën dhe faunën e saj. Por jeta, zhvillimet ekonomike kanë qenë të lidhura historikisht me Detin Adriatik. Këtij qyteti Zoti nuk i dha tokë të mjaftueshme as pasuri nëntokësore por i dha detin dhe me një bregdete i cili u bë një nga portet kryesore Mesdhetare në hapësirat pafund detare. Që i vogël kisha dëgjuar nga nëna ime se ulqinakët janë njerëz të qetë, të zot të detit dhe se ulqinakët janë nikoqirë, merrte si shembull që një hallë e saj nga fisi Beqja ishte dhënë tek fisi Bilalve (nëna e Shuajp Bilalit, në Tiranë), por ajo që më ofroi më shumë në lagjen time ishte fakti se në lagjen Kiras, Dudas kishin ardhur shumë familje Ulqinakësh dhe nga ato kam njohur shumë nëna ulqinake që i kujtoj me respekt edhe sot. Ata u dalluan në lagje si

besimtarë. Nuk e harroj zonjën Moradie Bashaj e shoqja e Tufikut, Cafas të vogël, apo Brahim Husi me të shoqen, familjen Kurtabegu (Kurti dhe e shoqja e tij Fiqiria), prind e shokut tim Brahim Kurtabegut. Kisha në kufirin e bahçes time në Kiras familjen e Sulejman Halilit, gjyshit të Çlirim Sulejmanit. Ardhja e ulqinakëve në Shkodër në fillim ato të qytetit dhe pastaj të fshatrave është lidhur me ngjarjet tronditëse ndaj popujve të Ulqinit nga pushtuesit Serbo -Malazez, të cilët në periudhat të ndryshme hakmerreshin ndaj këtij populli. Kështjella e Ulqinit është simboli i rezistencës të Shqiptarëve dhe Ulqinit ndaj Sllavëve. Në fillim në Shkodër para 200 vjetëve erdhën tregtarët e mëdhenj ulqinak, të cilët zotëronin kapital, anije dhe bënë tregti me Shkodrën dhe gjithë Mesdheun. Ato janë të njohur nga portet kryesore të Mesdheut si Aleksandria, Port Said, Tripoli, Bengaz e të tjera. Pra, me të gjithë portat e Mesdheut të botës Arabe. Duke parë nga afër jetën e ulqinakëve dhe duke lëvizur në vendet Arabe të Afrikës se Veriut mësova shumë nga historianët arab dhe historianët shqiptarë ngjarje shumë interesante për detarët ulqinak në fillim të shekullit XVI. Kështu ngjarja historike e vitit 1519 lidhet me veprimtarinë e katër vëllezërve ulqinak që janë Oruçi, Hajradini, Isaku dhe Iljazi të cilët vendosen për të ndërtuar një port

ushtarak edhe për strehim por edhe për tu maskuar në sulmet që bënë ato kundër piratëve spanjoll të cilët për dekada po plaçkitshin portet e Algjerisë dhe njeriu që i dha jetë këtij porti është Hajradini i cili u përkrah nga populli i Algjerian duke i dhënë dhe titullin drejtuesit Bejlebe. Akti historik i krijimit të portit dhe modifikimi i tij ushtarak dhe zhvillimi i mëtejshëm si një qendër politike e krejt Algjerisë bëri që Algjeri të mbesin kryeqytet i Algjerisë. Në këtë qytet drejtuan për 80 vjet Hajredini me vëllezërit e tyre dhe me djalin Hasanin që koncedon me periudhën 50 vjeçare drejtim të Algjerit, babë dhe bir në vitet 1519 - 1568. Flota e katër vëllezërve ulqinak ka hyrë në historinë e ngjarjeve në Algjeri, në veçanti në Algjer për kontributin e madh që ata dhanë për gati një shekull për të mbrojtur interesat e popujve arab të Algjerisë. Si historianët anglez ashtu edhe ato arab dhe shqiptarë nxjerrin në pah vlerën e Hasan Pashës i cili është zgjedhur në tre mandate në Algjer si drejtues i këtij qyteti, (djali i Hajradinit). Sot kur kanë kaluar 500 vjet nga ngjarjet e mëdha të detareve ulqinak në portin e Algjerit, ne krenohemi për kontributin e tyre në krijimin e Urës së Miqësisë të popullit shqiptar me popujt arab. Ajo që bie në sy është fakti se lëvizja e anijeve shqiptare në Mesdhe në veçanti të tregtarëve Shurdha, Luli, Bilali, Gjyli, Raizi, Ishmi,

Ulqinaku, Beci e të tjerë, tregojnë se në Mesdhe tregtarët ulqinak bënë një tregti të dendur në portet e Afrikës së Veriut por atë që bënë katër vëllezërit ulqinak duke ndërtua portin ushtarak të Algjerit dhe që për 80 vite drejtuan dhe mbrojtën Algjerin nga dyndjet e kryqëzatave spanjolle është me vlerë historike. Historianët Algjerian e kanë çmuar shumë kontributin e këtyre katër vëllezërve në veçanti shkruan historianin Abdurrahman Ibn Musa, historiani Abu S'dullah, historiani Buh'abdahi, (Algjerian), historiani anglez Viliam Spencest (USA) 1976 e të tjerë. Historiani Dr. Abu al Kasem Se'dullah në veprat e tij historia e Algjerisë shkruan shumë gjatë për shqiptarët, në veçanti për katër vëllezërit nga Ulqini (Algjer 1981). Dokumentet burimor për këtë ngjarje historike të përcaktuar edhe nga historianët të huaj por dhe nga Algjerianët janë bërë objekt studimi për disa vite dhe për historianin e mirënjohur shqiptar Profesor Muhamet Mufaku, i cili ka punuar për dekada në Jordani.

Pasha i fundit në Algjeri është Mami -Arrnaut. Ky pasha shqiptar drejtoi për disa vite Algjerin. Duhet pranuar se drejtimi i Algjerit nga 1519 -1830 është bërë nga Pasha Shqiptar. Kjo na bën ne krenar për historinë e bashkimit tradicional ne shekuj në popujt arab.

Edhe sot, Shoqata e Miqësisë punon për të krijuar ura të reja bashkëpunimi në mes popujve tanë dhe shpalos historikun e popujve arab.

MUAMER VUÇI

# “VIRTYTI I DITURISË”, me autor Pashk Mhill Alia

PROMOVIMI: "VIRTYTI I DITURISË", PËRCJELL  
MESAZHE: DITURIA ËSHTË NJË MISION PA  
FUND, QË VIJON GJATË GJITHË JETËS, ME AU-  
TOR PASHK M. ALIA


Është promovuar në qytetin e Lezhës, libri "Virtyti i Diturisë", me autor Pashk Mhill Alia.

Libri: "Virtyti i Diturisë", është një libër i trajtuar nga këndvështrimi i virtytit "Dituria", i përgatitur mjeshtërisht dhe profesionalisht nga studiuesi i njohur Pashk M. Alia. Duke e parë kështu çështjen e diturisë njerëzore dhe të shoqërisë, që ta trajtojë si virtytin e parë ndër virtytet në tërësi, prej të cilit marrin rëndësi dhe vlerë edhe Virtyte të tjera, sepse nëse nuk kemi të ditur nuk mund t'i njohim dhe t'i administrojmë ato. Ky libër i arrirë, është edhe një mesazh, që përcjellët nga studimi i eksperiencave botërore, botë e cila ka hyrë në detaje të tilla qysh para njëqind vjetësh.


- Në këtë libër, kam trajtuar më së pari faktin, se dituritë tona, janë në funksion të lirisë sonë individuale dhe shoqërore, shkruan në këtë libër autori Pashk Alia. Duke e trajtuar diturinë në aspekte të rritjes njerëzore, të veprave njerëzore, si

aspekte të krijimit të një bote të dhënies dhe përcjelljes së mirësisë, aq shumë të nevojshme, si dhe trajtimi i diturisë lidhur me moralin njerëzor. Pa moral, nuk do të kemi kurrë dije të qëndrueshme dhe për këtë autori Alia e ka trajtuar diturinë si një mençuri dhe si një të vërtetë, duke trajtuar këtu me shumë finesë e profesionalizëm edhe dijet të shprehura në funksion të edukimit patriotik. Duke trajtuar dijet, që vijnë nga motivimi është parë nga autori i këtij libri, si një eksperiencë edhe personale, por edhe si përvojë e punës së psikologëve, sociologëve, neuropsikiatërve dhe mësuesve në shumë vende të botës. Një kapitull më vete përbën trajtimi i diturisë dhe meditimi, por edhe tek dituria e vetëdijshme dhe e ndërgjegjshme, se, nëse bëhemi të vetëdijshëm për dijet që duhet të marrim, apo për të njohur paditurinë, që kemi në vetvete dhe kjo të bëhet me vete ndërgjegje, nuk mund të motivohemi drejt njohjes, dijeve dhe diturisë.

**JAK RROZHANI**, gazetar e publicist



## Shtatzënia aksidentale



Është interesant fakti që, të rinjtë e sotshëm, madje edhe të rriturit, pretendojnë se, i kanë njohuritë e nevojshme, mbi seksin. Edhe nëse nuk kanë lexuar kurrë, qoftë dhe një faqe të vetme literaturë mbi seksin. Adoleshentët nuk e dinë absolutisht se, çfarë duhet të dinë për seksin. Edukata seksuale që mësohet në shkollat tona është një përrallë. Asgjë më tepër. Kush është programi dhe, kush janë mësueset që e zhvillojnë programin? Janë një mjerim i vërtetë.

Shturje, mendjelehtësi, përfitim, degradim i vlerave të femrës, vihen re këto vite të anarkisë sociale. Femra është bërë objekt i sulmeve seksuale, me dhe pa para, me dhe pa dëshirën e saj. Propaganda pornografike ka shpërthyer të gjitha digat dhe, nëpërmjet shtypit, televizionit, internetit dhe të gjitha rrjeteve sociale, është kthyer në një rrezik aktual për rininë tonë.

Në problemet seksuale nuk ka vogëlsira. Ajo që shpesh mund të mendohet si vogëlsirë, pas kryerjes së aktit, nuk mbetet më e tillë. Kurrë nuk duhet bazuar në principin e mallkuar "ndoshta". "Ndoshta nuk mbetet shtatzënë, ndoshta nuk i jap apo marr sëmundje prej saj".

Një njohje e mirë e teorisë seksuale nuk do të thotë vetëm që të dish të kënaqësh partnerin tënd në krevat, por në radhë të parë dhe, mbi të gjitha, që ta mbrosh veten tënde dhe partnerin nga rreziku i seksualitetit.

Shtatzënia e padëshiruar ose aksidentale, në shumë raste, është jo vetëm një burim konfliktesh në familje, por edhe një shkak për vetëvrasje të femrës. Logjikisht dhe ligjërisht është i pakuptueshëm fakti që, një vajzë e re, e mbetur shtatzënë, t'i japë fund jetës, duke bërë vetëvrasje. Por ja që pushteti i moralit dhe, gjendja e vështirë ekonomike, i detyron ato që t'i japin fund jetës, në mënyrë tragjike, me vetëvrasje direkte.

Krahas vrasjes direkte, tek femrat tona është e njohur edhe vetëvrasja tjetër, ajo indirekte, që vjen si pasojë e vetë ndërhyrjeve për ndërprerjen e shtatzënisë. Sidomos në zonat rurale kjo ka qenë edhe mbetet shumë e njohur, e cila ka marrë shumë jetë femrash. Edhe nëse nëna do të mbijetojë nga një ndërhyrje e tillë, kaq primitive për ndërprerjen e shtatzënisë, pasojat që ajo mund të ketë më vonë, mund të jenë shumë të mëdha. Të mos gëzohet se ia hodhi!

E vetmja rrugë, humane dhe ligjore, për ndërprerjen e një shtatzënie të padëshiruar është ajo me mjekun gjinekolog.

Shtatzënia "aksidentale" (e padëshiruar), shkencërisht, nuk njihet. Kjo, gjithmonë, është pasojë e mosnjohjes së masave dhe rregullave të sigurimit gjatë aktit

seksual. Sot, në farmaci dhe, tek mjeku gjinekolog, gjenden të gjitha mjetet e mundshme, për t'u mbrojtur nga rasti i shtatzënisë së padëshiruar.

Mbrojtja nga shtatzënia është çështje e të dy partnerëve dhe kurrë nuk duhet menduar vetëm si problem i femrës.

Mënyra e mbrojtjes nga shtatzënia duhet të përcaktohet nga të dyja palët, gjithashtu edhe mjetet që do të përdoren për këtë qëllim.

Nëse me të vërtetë do të ndodhë një shtatzëni e padëshiruar, të dy janë fajtorë dhe, të dy, duhet t'i ndajnë pasojat bashkë. Duke pasur parasysh pushtetin e fanatizmit që sundon akoma tek ne, në të gjitha rastet femrat janë ato që e vuajnë më shumë rastin fatkeq. Ato mbeten fajtoresh, ato ndëshkohen deri në vetëvrasje. Femra, në raste të tilla, do të ndodhet përpara një mijë e një pyetjeve pa përgjigje dhe, një mijë e një paragjykimeve të fanatikëve dhe primitivëve. Vështirë se mund të mendohet një hata më e madhe për femrën shqiptare se sa një shtatzëni aksidentale, e padëshiruar.

Ajo që unë do t'i këshilloja çdo femre në raste të tilla, është: Kokën lart! Për nderin dhe jetën tënde, je ti ajo që duhet të vendosësh. Askush tjetër!

Një shtatzëni e padëshiruar nuk është edhe fundi i botës, pavarësisht se në ç' rrethana mund të ndodhë ajo.

Në rastet e dyshimit për shtatzëni, në radhë të parë duhet që, me shumë kujdes dhe, durim të bëhen të gjitha provat e mundshme për ta vërtetuar atë. Kjo nuk bëhet me hamendje dhe duke pyetur maminë apo gjyshen, por duke shkuar tek mjeku. Farmacitë sot janë paji-

sur me materiale testimi për shtatzëni, të cilat kanë një përdorim shumë të thjeshtë dhe tepër sekret pasi çdo femër mund t'i përdorë vetë në banjën e shtëpisë apo diku tjetër si kjo.

Nëse vërtetohet se jeni shtatzënë, durimi është kyçi i të gjitha zgjidhjeve normale dhe njerëzore. Merr frymë thellë dhe hidhe vështrimin larg, duke harruar, të paktën, për pak kohë atë që të ka ndodhur. Pas kësaj duhet të vihesh në rrugën e informimit ligjor, si për rastin kur do që ta mbash fëmijnë dhe, për rastin kur do të bësh ndërprerjen e barrës.

Gjithçka që do të ndërmerrni në këtë drejtim, duhet ta bëni vetëm nëpërmjet ligjit dhe mjekut.

Për gjithçka duhet të vendosni vetë. Shtatzënia juaj nuk është puna e të tjerëve, kushdo qofshin ata.

**LEKË IMERAJ**, shkrimtar,  
përkthyes, publicist



# At Shtjefën Gjeçovi në 75-vjetorin e themelimit të arkeologjisë shqiptare

## Themeluesi i arkeologjisë shqiptare

**Nga Frank Shkreli  
Ish-Drejtor i VOA-s për Euro-Azinë\***

“Këto punë po i shkruaj këtu, o vëlla shqiptar, jo me ndonjë qëllim të keq, por pse po ma ka ënda me e mbështetë në to vjetërsinë e kombit tonë. Le ta marrë vesh bota se hyjnitë, mënyrat dhe sjelljet e besimtarëve, si grekët dhe latinët e vjetër, i patën prej etërve tanë, Pellazgëve”. At Shtjefën Gjeçovi

Ditën e mërkurë, në sallën “Aleks Buda” në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë filloi punimet “Konferenca Arkeologjia shqiptare në 75-vjetorin e krijimit të saj: arritje, risi dhe perspektiva”, organizuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, njofton Gazeta Telegraf e Tiranës. Çelet Konferenca “Arkeologjia shqiptare në 75-vjetorin e krijimit të saj: arritje, risi dhe perspektiva” organizuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës | Gazeta Telegraf.

Sipas artikullit të mësipërm, me këtë rast, përshëndeti edhe Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, Në fjalën e tij përshëndetëse, Z. Gjinushi theksoi, sipas gazetës Telegraf, se gjithçka filloi nga viti 1948. Çdo gjë u “institucionalizua si kërkim i specializuar me mbështetje shtetërore në vitin 1948...”, ndërkohë që “brenda dy dekadash u kapërcy romantizmi shkencor”, citon Gazeta Telegraf, Gjinushi, i cili përmend emrat e disa arkeologëve të kohës komunizmit, pa dyshim për meritat e tyre në fushën e arkeologjisë shqiptare. Më ra në sy se Z. Gjinushi nuk përmendi At Shtjefën Gjeçovin, françeskanin shqiptar, i cili konsiderohet nga shumë ekspertë, të brendshëm dhe të jashtëm, si babai i arkeologjisë shqiptare – “I pari arkeolog shqiptar”, e ka cilësuar Gjeçovin At Zef Pllumi në librin e tij Françeskanët e Mëdhej”. At Zef Pllumi shprehet se mund të thuhet se At Gjeçovi, “pa dyshim që kurrnji udhëtar i shkencës nuk e përshkoi mbarë Shqipërinë që nga Veriu deri në Jug ma shumë se ai”. Siç duket Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Z. Gjinushi e konsideron punën dhe veprimtarinë e At Shtjefën Gjeçovit si një “romantizëm shkencor” që duhej, jo vetëm të “kapërcehet”, sipas tij, gjatë kësaj konference, por që edhe të zhdukej e të mos përmendej në vazhdimësinë e historisë “shkencore” të komunizmit. Çdo gjë filloi nga ne, nga viti 1948, thotë Gjinushi me shokë, ne jemi fillimi, ne vazhdojmë të jemi!

Françeskani At Shtjefën Gjeçovi, “themeluesi i arkeologjisë shqiptare” ishte dhe mbetet pishtar i gjallë i ndriçimit të historisë dhe kulturës së kombit shqiptar, të cilat u bënë për të vlera shpirtërore dhe qëndrese deri në frymën e fundit.

Por për fat të mirë, gjithçka nuk është e humbur se Z. Gjinushi e pa të arsyeshme


të “kapërcente” emrin e At Shtjefën Gjeçovit në konferencën kushtuar 75-vjetorit të themelimit të Arkeologjisë Shqiptare. Sepse sipas përshkrimit tek Gazeta Telegraf në atë konferencë mori pjesë e përshëndeti edhe Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Republikës së Kosovës, Akad. Mehmet Kraja. Gazeta Telegraf shkruan se Akademiku Kraja shprehu respekt për të gjithë ata që në çfarëdo mënyre kanë zbuluar se në këtë hapësirë, edhe përkundër furtunave dhe erozioneve të mëdha, toka flet shqip! Ai foli për arkeologjinë në Kosovë – në trojet dardane – ku sipas tij ajo ka kaluar periudha të errëta, periudha kur dëshmia për vazhdimësinë iliro-shqiptare ndëshkohej herë me plumba, si në rastin e (At Shtjefën) Gjeçovit, ose me helmim, si në rastin e antropologut hungarez Nemeskeri, i cili supozohet se u helmua, pasi dërgoi një raport paraprak se Nekropoli Mesjetar i Vërmicës dëshmonte për një popullsi josllave, me vazhdimësi nga shekulli II para epokës së re, V dhe VI në mesjetën e hershme dhe më vonë në shekujt IX-XI. Kjo vazhdimësi iliro-shqiptare në ish-Jugosllavi konsiderohej armiqësore, aq sa që mund të ndëshkohej edhe me vdekje. Në lidhje me këtë, sipas Telegraf, Akademiku Kraja theksoi kontributin e “At Shtjefën Gjeçovit, themeluesit të arkeologjisë shqiptare”, siç e cilësoi ai.

*“Mua edhe mund të më vrasin, por gjuhën dhe kombin shqiptar nuk do të mund t'i vrasin kurrë...”*

“Prifti françeskan Shtjefën Gjeçovi-theksoi akad.Kraja, sikundër e dini, ka lindur në Janjevë, ku më pas, gjatë kohës që unë mbaj mend, jetonte një komunitet i krishterë katolik. Shtëpia e tij e lindjes gjendet atje edhe sot, vetëm se pushteti jugosllav ku ishin të përfshirë edhe një numër kosovarësh nuk e deshën Shtjefën Gjeçovin, të cilin jo vetëm që e vrau më 1929, por nuk i bëri as nderimet që i takonin një burri mendjendritur, i cili la trashëgimi dy monumente të pavdekshme: themeloi arkeologjinë shqiptare dhe kodifikoi veprën më të rëndësishme të trashëgimisë zakonore shqiptare, Kanunin e Lekë Dukagjinit”, ka thënë Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Republikës së Kosovës Dr. Mehmet Kraja.

Dr. Kraja njoftoi të pranishmit, ndoshta

një lajm që ata të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, përfshirë Z. Gjinushi- nuk donin të dëgjonin me rastin e 75-vjetorit të Arkeologjisë Shqiptare. “Ju bëj me dije,-



ka thënë Kraja se “Akademia e Kosovës do të kërkojë zyrtarisht nga institucionet e Kosovës, që viti 2024, i cili bie në 150 vjetorin e lindjes së Shtjefën Gjeçovit, të shpallet zyrtarisht si “Viti i Gjeçovit”. Kjo është më e pakta që mund të bëjmë në respekt të atij që i pari ndër shqiptarët dëgjoi zërat nga thellësia e tokës sonë që flet, ku citohet (nga Gazeta Telegraf), të ketë thënë Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Republikës së Kosovës. Uroj që ky njoftim i përmasave kombëtare nga Dr Mehmet Kraja të mos ketë ra në veshë të shurdhët të akademikëve të Tiranës zyrtare. Por që vitin që vjen, me rastin e 150-vjetorit të At Shtjefën Gjeçovit të kujtohet së bashku në Prishtinë dhe në Tiranë “Emëri i këtij njeriu të rrallë”, siç e ka cilësuar Faik Konica.

*Foto nga konferenca dy ditore me rastin e 75-vjetorit të krijimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë.*

Ka mundësi që Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe enti akademik e shkencor që ai kryeson të kenë zgjedhur që me këtë rast të anashkalojnë emrin e At Shtjefën Gjeçovit, të cilin disa ekspertë dhe akademikë e quajnë theme-

luesi i Arkeologjisë Shqiptare vetëm e vetëm se ishte prift katolik. Se emri, puna dhe veprimtaria e At Shtjefën Gjeçovit, në sytë, mendjen dhe në përgatitjen e tyre shkencore marksiste-leniniste, mund të jetë një “romantizëm shkencor”, që duhet të “kapërcehet” në minimum ose të zhduket fare nga kujtesa, në maksimum.

E vërtetë se At Shtjefën Gjeçovi për veçse ka qenë prift katolik dhe arkeolog, ai, sipas Dr Syrja Pupovcit, duhet të shikohet dhe të vlerësohet edhe si, mësues e arsimues, punëtor i kulturës dhe shkencës, për kohën në të cilën ka jetuar. “Shtjefën Gjeçovi i ka dhënë kontribut të rëndësishëm kulturës kombëtare dhe shkencës dhe ka lënë në trashëgimi vepra që do të mbeten edhe në të ardhmen gurrë e pashtrur për studime”, -ka shkruar pedagogu dhe akademiku i njohur nga Kosova, Dr. Syrja Pupovci (1937-1998). Ndërsa një admirues i deklaruar i At Shtjefën Gjeçovit, Faik Konica i madh është shprehur kështu për Gjeçovin: Bir i perulët i Shën Franciskut, e ditur me një dituri pa tingëllim, po dhe Shqiptar i kthiellte. At Gjeçovit, që

i përkiste çdo mirësi, nuk i mungoi asnjë hidhërim, asnjë çpifje, më e çuditshmia e të cilave ndoshta është të mohuarit se ay ish Shqiptar. Sepse kish lindur në një kufi gjühërash, në një kufi ku sot mbaron shqipja dhe nis një tjetër, ca mëndje të klasës katërt, të pazonjat të kuptojnë se fólësit e shqipes në vijën me të përparuara janë stërnipërit e atyre që me qëndrimin e tyre në Kohën e Mesme dhe pastaj ndaluan të mbrápsurit e vijës, ca mëndje të klasës katërt e përmbysin të vërtetën dhe e kthejnë në të sharë atë që është një lavdi.”

“Secilidò prej nesh, miq dhe admironjës të tij, do të kishim nevojë që në gjallësi për nga një lotore ku të mbledhim lotët tona për At Gjeçovin”. “Po, At Gjeçovi është përmi çdo sharje. Emëri i këtij njeriu të rrallë do të vejë duke u-rritur dhe një ditë famullia e Gomsiqes do të jetë një nga gurët e shënjtëruar të Shqiptarësisë.” Faik Konica -Kujtime mbi At Gjeçovin – Gazeta “Dielli” e organizatës Panshqiptare Vatra, 18 Mars 1930, nr. 5156, fq. 2.)

**Marre nga gazeta  
“Telegra”, 8 Nëntor 2023**



# “Mountain View Resort” Perlë mes Alpeve shqiptare në Vuthaj

Bukuri e rrallë dhe e frikshme. Shpatet pranë e pranë dhe ti depërton mes tyre. Ky imazh dhe këto maja malesh magjepsin çdo vizitor që depërton në zemrën e Kelmendit. Edhe një përshkrim, pa ndalesa në Kelmend, të frymëzon. Edhe pas xhamit të një makine, në heshtje, shijon gjithë format e papërsëritshme të relievit. Lëpusha të tundon t'i shkosh, por do mjaftohemi vetëm me një vështrim nga këtu mbi gjithë luginën.

Pa hyrë në Vermosh, kthehemi drejt doganës. Kufiri me Malin e Zi është vetëm 500 m pranë. Zhurmat e ujerave që përplasen me furi në kanionin Bashkimi, tërheqin vizitorët, qoftë dhe ata që rastësisht kalojnë këtej. Tashmë ky vend është kthyer në një destinacion turistik në bashkinë Malësi e Madhe. Sot gjenden këtu dy grupe vizitorësh, nga Lezha dhe Tirana.

Doganat shqiptare dhe malazeze këtu vijnë në dy godina të ndara. Drejtuesit e automjeteve paguajnë një siguracion prej 15 eurosh. Kërkohej një dokumentacion i rregullt, në të kundërtën edhe mund të të kthejnë.

Hyrja në territorin e Plavës dhe Gucisë shoqërohet me emocione. Ndodhesh në vijimësinë e bjeshkëve të Kelmendit, në vijimësinë e trungut shqiptar, por të copëzuar nga kongresi famëkeq ë Berlinit. Në 1878 këto territore iu dhanë padrejtësisht Malit të Zi. Dy qytezat, me 29 fshatra, u zunë “robina” prej asaj kohe e deri më sot. Robina të një historie të nëmur, përballë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Ali Pashë Gucisë. Prej atëherë, bjeshkët tona, nga më madhështoret, zunë të thirrën “Bjeshkët e Nemuna”, shkruan studiuesi Ndue Dedaj në një shkrim të tij.

Dy komunat e ndara nga qeveria malazeze, sollën dhe më tej përçarjen dhe asimilimin e shqiptarëve. Në Guci shqiptarët zënë 35% të popullatës, kurse në Plavë as 20%. Emigrimet, që nisën vrullshëm në kohën e Titos, e që vijojnë dhe sot, e tkurren popullatën shqiptare, duke e kthyer atë në një pakicë kombëtare, në trojet e të parëve.

Teksa ngatërruam pak rrugën në drejtim të Vuthajve, më kot shpresuam të pyesnim ndonjë shqiptar të rastësishëm. Të gjitha përgjigjet i morëm në gjuhën malazeze.

Bukuritë natyrore këtu janë të jashtëzakonshme. Për to do të flasim edhe në vijim të reportazhit, por të bën përshtypje që investimet në fushën e turizmit këtu janë fare të pakta.

Arif Qosja ka 8 muaj që është kthyer me vajzën e tij Sanijen që të jetojnë përfundimisht në vendlindje, Vuthaj. Gjithë kapitalin e vënë përmes punës së tij të ndershme prej 35 vitesh në NY, e sollin në Vuthaj, ku dhe ka ndërtuar këtë resort. Por mesa kuptohet si këto raste këtu janë tepër të rralla. Ne zhvilluam një bisedë me ta, por dhe dy miqtë e tyre Gjovalin Nikçin dhe Sherif Ulaj, banorë të fshatit.

Në Plavë e Guci vijon asimilimi i shqiptarëve nga qeveria malazeze. “Më herët na

kanë ngru me zor, tani me laps”, - shprehet Gjovalini. Ai njëherësh është dhe gazetar i cili ka bërë një analizë të plotë mbi problemet e investimeve të shqiptarëve që i ka pasqyruar në “Koha javore”, e vetmja gazetë shqiptare në Mal të Zi. Rast konkret që e dëshmon këtë është z. Arif Qosja, i cili ka 2 vite dhe ende nuk ka përfunduar procedurat e lejeve të ndërtimit dhe funksionimit të resortit të tij. Këto pengesa i detyrojnë shqiptarët të mos

por duket e bindur për vendimin që ka marrë.

Por le të flasim për resortin e ndërtuar këtë vit në Vuthaj.

“Mountain View Resort” është një perlë mes perlave që Zoti e ka bekuar tokën shqiptare në Vuthaj. Në një harmoni të plotë me natyrën, këtu dora e njeriut e ka përmirësuar atë, i ka dhënë hijeshi, e ka bërë të shfrytëzueshme, relaksuese. Kuro-ra e lartë e maleve, me petkun që e ndër-



kthehen në vendlindje, t'ua vështirësojnë ardhjen këtu. Fshati Vuthaj, aktualisht ka më pak se 200 banorë. Prej 1960 e deri sot, 90% e popullatës kanë emigruar. Ata kanë pasur sukses në botë, sepse janë punëtorë e të mençur. Këtë e dëshmojnë bizneset e tyre në tokë të huaj. Sa janë kthyer në vendlindje? Vetëm 5-6 emigrantë. Sanija ka përfunduar 2 fakultete në Neë York,

ron sipas stinëve, duket si një mbrojtëse e këtij resorti nga erërat e forta. Gjëlberimi që vesh shpatet ka krijuar një amfiteatër të mrekullueshëm, në të cilin ky resort është një ide e jashtëzakonshme që u krijua dhe u ndërtua. Shtëpizat me kapuçat gjigandë të jeshilet, të vendosura si notat e një simfonie, tërheqin menjëherë vëmendjen e vizitorëve këtu, edhe të atyre

që nuk kishin asnjë informacion për këtë vend. Punimet nisën 4 vite më parë dhe vetëm prej 3 muajsh resorti ka hapur dyer për të gjithë ata që dëshirojnë të kalojnë 1 apo më shumë ditë pushimi këtu. Në vijimësinë e këtij reportazhi, ne do t'ju njohim me mundësitë e argëtimit që ofron “Mountain View Resort”.

Nuk do mjaftonte vetëm t'i shikonim motorë-makinat, por dhe t'i shijonim ato. Po ashtu dhe 20 biçikleta janë në dispozicion të vizitorëve. Për fat të mirë në Vuthaj pikat turistike, janë fare afër me njëra-tjetrën dhe mund të shkohet pranë tyre pa një mundim të madh. Kjo trevë etnike shqiptare, qysh në lashtësi ka qenë e njohur me emrin “Vuthaj” ose “Kantundi Vuthaj”. Por, duke pasur parasysh shtrirjen, kompaktësinë e territorit dhe të banorëve, largësinë nga njëri fshat tek tjetri, themi se është një krahinë e vogël shqiptare në zemër të alpeve, me bukuri mahnitëse, me karakteristika lokale të veçanta. Këto troje përfshijnë një territor të madh me lugina e vende bujqësore me bjeshkë livadhe dhe gardhe nga Burimi i Valbonës deri tek Burimi i Ali Pashë Gucisë, nga liqeni i shtarës deri tek Guri i Gjon Bales, nga Guri i Sahatit deri tek shkalla e Vuthit. Është pjesë përbërëse e Kelmendit të hershëm. Kufizohet me treva të tjera shqiptare: Malësia e Gjakovës, Dukagjinin, Bjeshkët e Kelmendit të Gurit, Gucinë dhe Plavën. Prandaj themi se ky vend përbëhet nga një territor i ngjeshur, me bjeshkë e male të lidhura në mes tyre.

Emigrantet, edhe pse me dekada të larguara nga vendlindja e tyre janë kujdesur që çdo vit të sjellin familjet këtu, për këtë ata kanë ndërtuar edhe shtëpitë e tyre, çka dëshmojnë dhe një potencial ekonomik.

Por le të njihemi me bukuritë e zonës.

Syri i Skafkaçit është një nga bukuritë natyrore shqiptare. Ndodhet nën majën e Rosit dhe është pjesë e Parkut Kombëtar të Bjeshkëve të Nemuna, të Alpeve Shqiptare. Njihet dhe si syri i Kaltër i këtyre anëve falë ngjyrës së tij, ujit të pastër transparent dhe të natyrës së paprekur që e rrethon. Nga ky burim del lumi Gër-rla, i cili rrjedhë nga një kilometër mbi sipërfaqe dhe kridhet në greminë duke e krijuar Ujëvarën e Hartinit një bukuri të rrallë të fshatit Vuthaj dhe krejt kësaj ane.

Sanija, vajza vuthjane e lindur dhe rritur në NY, na befason me shkathtësinë e saj mbi motor....Ndalesa e radhës do të bëhet pranë ujëvarës së Gërllës. Është fare pranë Syrit të Skafkacit. Ajo ka një formë magjepsëse. Ujerat që vijnë nga syri i Skafkacit derdhen këtu, por ndryshe nga ujëvarat që jemi mësuar të shohim, uji e merr lartësinë nga pozicioni i këmbëve tona dhe bie poshtë disa metra në një shpellë natyrore të mbushur plot me ujë.

Qëndrimi ynë do të jetë i shkurtër, për faktin se në Vuthaj do të jemi vetëm një ditë. Ndien një lloj keqardhje kur largohesh nga kjo luginë, e mbushur plot shtigje, që presin të eksplorojnë. Ndoshta



këtu qëndron dhe vlera më e madhe e Vuthajve, por dhe Plavës dhe Gucisë, janë vende pothuajse të virgjëra të panjohura ende mirë nga vizitorët.

Në kthim, ndalemi tek një fermë me gomarica, e cila është ndërtuar nga z. Arif Qosaj. Edhe pse njihen vlerat e qumështit të këtyre kafshëve, në Shqipëri ende nuk është ndërtuar një e tillë. Mësojmë se një litër qumësht shiten në tregun evropian 60-80 euro. Vlerat e tij janë mjaft kurative, kryesisht për kollën e mirë. Në Vuthaj gjen dhe mjaltë mjaft të mirë. Një litër shkon 20-25 euro.

Por le të risjellim në vëmendjen e teleshikuesve "Mountain Vieë Resort", detaje të tjera mjaft interesante, të cilat na vlejnjë për tu informuar dhe mësuar se përse duhet ta vizitojmë atë nga afër.

Këtu do gjeni 20 shtëpiza dykatëshe prej druri. Mësojmë se nuk ka pse të merakosemi nëse jemi më shumë se 5 vizitorë në një grup. Ka shtëpiza që zënë edhe më shumë.

I pakundërshtueshëm është fakti, se pushimet duhet të shoqërohen edhe nga një gatim tradicional i zonës, sidomos në këtë zonë, ku ajri i freskët, por dhe shëtitjet, të shtojnë oreksin. Mentor Kukaj, është një profesionist i pasionuar pas kuzhinës.

Janë dhe pijet e veçanta të përgatitura nga frutat e fshatit, ku dominon lëngu i boronicës.

Në resort nuk është ekzagjeruar me ndërtimet e mëdha. Ky restorant me kapacitet 150 vendesh është i mjaftueshëm për momentin. Elementi dru i përdorur të jep një ndjesi rehatije këtu. Çdo punim është bërë nën drejtim të z. Arif Qosaj, i cili ka pasur për shumë vite në NY firmën e tij të ndërtimit.

Në fakt kopshtin e kafshëve përtej lumit e pikasëm që në fillim, por nuk donim të dukeshim fëmijë dhe të vraponin që në fillim atje. Provojmë të hipim në ndonjërin nga kuajt, por më kot tregojmë



trimëri, edhe pse stafi që të vendoset në dispozicion të jep siguri maksimale. Sa në harmoni të plotë qëndron natyra rreth resortit, por edhe vendosja e kafshëve aty pranë, duke ua lejuar rritjen natyrore. Këtu gjen edhe strucin, apo dhe patat që

së bashku krijojnë një kuartet të bukur natyror.

Pranë Bradës së Vezirit, Romanit dhe Bjelicit, ... në fund Zastanit... anash malet e Borevet, do të gjendet edhe kjo lëndinë, ku drerët do të jetë e vështirë t'i kapim me

kamerë.

Duket sikur mbrëmja këtu zbret me shpejt nga atje ku kemi ardhur. Jo pse dielli ka ritëm tjetër perëndimi, por dita është plot aktivitete dhe koha kalon pa u kuptuar. Mes vizitorëve ka dhe të afërm që vijnë këtu, por ne e kemi të vështirë të bëjmë dallimin, pasi mikpritja është e barabarte për të gjithë.

Teksa kthehemi nga shëtitjet tona në resort, diskutojmë për ato që kemi parë. Shpesh mendimet ndërpriten nga takimet me miqtë e rijne. Të gjithë sillen thjesht dhe të dashur, aq sa vështirë e ke të kuptosh se kush është shefi këtu. Edhe pse temperaturat jashtë kanë rënë ndjeshëm gjejmë në verandë turistë nga Kosova që kanë ardhur këtu me motorë, e që do e kalojnë mbrëmjen këtu.

Reflektojmë mbi gjithë sa pamë sot. Rruga e lehtë për të ardhur deri këtu, vetëm 2 orë nga Shkodra, mes peizazheve mbresëlënëse. Përpjekjet e vëllezërve tanë për tu kthyer dhe ndërtuar vendin e tyre pavarësisht pengesave nga qeveria malazeze, bukuritë e pafundme natyrore të paprishura nga dora njerëzore dhe pak të njohura nga vizitorët shqiptarë, një mikpritje e pandryshuar si në kohë të vjetra, gatime tradicionale, adrenalinë me motorë dhe miqësi me kafshët në natyrë, për ta mbyllur në fund me një shtëpizë druri në netët me yje. A nuk janë të gjitha këto arsye për ta vizituar nga afër "Mountain Vieë Resort" në Vuthaj të Gucisë?! Jemi të bindur se do e ndërmerremi një udhëtim, e pse jo, dhe të na falënderoni që e bëmë të njohur përmes këtij reportazhi. Shijoni, magjinë e Plavës dhe Gucisë, mes Alpeve Shqiptare.

**Gazetare Kozeta Bruci,  
Shkodër, më 8.11.2023**

# ETJA PËR DIJE DHE KRIJIMTARI E NJË STUDIUESI DHE POETI...

- Në vend të një urimi për ditëlindjen e një arsimtari shembullor, publicisti, studjuesi dhe poetit Luigj Shyti -

Është e natyrshme, njerëzore, e dobishme, madje edhe e domosdoshme, që pas 50 vitesh pune të përkushtuar, 45 prej të cilave në arsim, 32 nga këto drejtor shkollash 8- vjeçare dhe të mesme, duke qenë i angazhuat dhe një nga publicistët më të dëgjuar prej dekadash në shtypin e Shkodrës dhe atij qendror, pas dekadash studime të thelluara, të konkretizuara në disa vepra si: studime historike, në kulturë e art, publicistike dhe poezi, vjen një kohë, dhe për ne, shokët e tij, të ndalemi dhe t'i hedhim një këqyrje rrugës dhe jetës së bashkëkohësit dhe bashkëmohatarit tonë Luigj Shytit, në këtë përvjetor të ditëlindjes së tij. E ndërsa ne, shohim me krenari arritjet e shokut tonë, të konkretizuara me një dyzenë me vepra për Dukagjinin dhe nga Dukagjini, na krijohet ndjesia se, Luigj Shyti dhe Dukagjini janë rritur, burrëruar e përparuar në trupin e njëri-tjetrit. Dukagjini dhe Luigji ecën bashkë nëpër kohë, kohën e 50 viteve më të vrullshme të jetës. Dukagjini "shikonte" veten dhe Luigjin si ecnin paralel me të njëjtin ritëm. Ndërsa studiuesi dhe poeti i ardhshëm, shikonte jo vetëm realitetin e kohës, por edhe thellësinë e jetës dhe shpirtit të Dukagjinit dhe dukagjinave. Dukagjini e lindi, e rriti, e burrëroi, e "thithi" si magnet në gjirin e vet. E, Luigji, në jetën dhe shpirtin e Dukagjinit, gjeti thesaret e vjetra dhe të reja, dramet dhe heroizmat, fitoret krenare, atdhedashurinë e pashoqe, besën dhe burrërinë, etjen për dije, kulturë, arte dhe studime. Mjafton të kujtojmë se: në studimet e Luigj Shytit, në rreth 40 vitet e fundit, nga Dukagjini dhe për Dukagjin, gjenden të evidentuar mbi 45 studiues dhe krijues, me rreth 250 botime në disa fusha arti, kulture, historie dhe shkence. Njeri nga të cilët është edhe Luigj Shyti, në disa drejtime të historisë dhe kulturës materiale e shpirtërore dhe jetës në Dukagjin.

Kjo lidhje kaq e pandashme, si malet me tokën, e Luigjit me dukagjinat dhe Dukagjinin, e anasjelltas, pas vite e vite pune studimore, u konkretizua në mjaft vepra të rëndësishme, disa nga të cilat të pa trajtuara nga askush më parë. Kur mëson se, e tërë kjo punë e mrekullueshme nga Luigji Shyti, është bërë pa asnjë ndihmë, asnjë përkrahje nga institucionet e shtetit, as leje krijuese, as ndihmën për t'i botuar, as për t'i shpërndarë a publikuar, atëherë respekti dhe krenaria për të, shtohet.

Nuk ka se si, ne shokët e tij, në këtë rast, ta kursejmë fjalën e mirë, për këtë dukagjinat të florinjte, të etur për dije dhe krijimtari.

Një nga punimet më mbresëlënëse, më e dobishme, e që duhet konsideruar arritja më madhështore, në 100 vitet e fundit në Dukagjin, e Luigj Shytit, është vepra studimore, dhe si bija e saj kultura: "Historik

i arsimit dhe i kulturës në Dukagjin 1917-2017". Kjo mrekulli arsimit dhe kulture, u bë e mundur vetëm pas LANÇ, ku në pak vite u bënë kapërcime shekullor. Nuk ishte lehtë që në një dekadë e gjysmë, në Dukagjin, që jo vetëm të kapërcenin alfabetizimin shekullor, por edhe të hapen perspektiva për kulturë, art, dituri, krijimtari e studime. Dhe ta mendosh se kjo u arrit në një zonë si Dukagjini, ku koha për arsim e kulturë kishte mbetur në kohët e largëta otomane. Dukagjinatit endeshin fshatrave me orë të tëra për të shkruar e lexuar dy gisht letër, a një dokument qeverie, deri tek meshtari i krahinës. Dhe, ky, frati, rrinte si i vetmi përdor i diturisë, i kësaj mundësie, dhe si gardian sulltani,

E dyta: Luigj Shyti, krahas formimit të vet me shkollë e dituri bashkëkohore, nuk u kufizua vetëm tek puna dhe detyrat e caktuara. I lindur, i rritur dhe formuar në Dukagjin, në këtë krahinë me vlera dhe pasuri të mëdha, me bukuri përrallore, me histori zëmardhe, të tjera më pak ose aspak të njohura nga opinioni i gjerë, edhe si eksplorim i vlerave, tamam si i atyre gjeologëve dhe arkeologëve, të cilët shkojnë duke hulumtuar gjithçka.

E ndërsa gjeologët e studiuesit e natyrës studiojnë tokën, klimën, studiuesi i ardhshëm Luigj Shyti, i kishte pak më ndryshe objektet, disi edhe më të vështira sepse duhej të studioje jetën dhe shpirtin e Dukagjinit dhe dukagjinave; jetën, tipa-

shpirtit të banorëve të tij. Por, le të shohim shkurtimisht disa nga veprat e botuara nga Luigj Shyti.

Dy veprat e tij "Dukagjini, rrugëtim në gjenezë", monografi, historike-etnografike dhe tjetra "Gjurmë- Syzime etnografike në Dukagjin", janë të një rëndësie jashtëzakonisht të madhe, jo vetëm për brezat bashkëkohës, por edhe për gjenëratat e ardhshme. Cilido autor, që do të bëjë studime të mëtejshme, në këto fusha, ose të ngjashme me këto, nuk mund të jetë i suksesshëm, pa ju drejtuar, studiuar dhe hulumtuar këto dy vepra të Luigj Shytit. E veçoj këtë për të thënë se, këto dy vepra të Luigj Shytit, plotësojnë kërkesat bazë, kërkesat shkencore të studimit, dhe



në mënyrë që padituria në Dukagjin, të sundojë sa më gjatë në jetën dhe shpirtin e malësorëve. Këta pervers, pas LANÇ, e shprehnin hapur maninë kundër këtij transformimi, ashtu si lypësi i Migjenit, që shprehte hapur manin neveritëse kundër padrejtësisë shoqërore. Në këtë arritje madhështore të Dukagjinit, në personalitetin e Luigj Shytit, si autor i këtij studimi, unë veçoj disa kontribute, merita dhe vlera të pazëvendësueshme, që nuk mund t'ia zbej as koha, as kush dhe asnjëherë.

E para Luigj Shyti, ka meritën që, pa u shkëputur asnjëherë nga Dukagjini, mbaroi tërë ciklet e arsimit, dhe punoj me devotshmëri shembullore si arsimtar dhe drejtues. Puna në arsim dhe në zona të ndryshme të Dukagjinit, dëshmon më së miri se: puna dhe kontributi i tij ka qenë në lartësinë e detyrës dhe të kërkesave të kohës, në mënyrë që Dukagjini, jo vetëm të eci paralel me kohën, por edhe të kapërcehen prapambetjet shekullore, duke u rreshtuar përkrah zonave më të zhvilluara të vendit, në ato vite.

ret, formimin e ndërgjegjes, hershmërinë, botën materiale, zakonet, fjalë e formime, këngë e vaje, mjete pune e lufte dhe jetese, veshjet dhe armët, tipa dhe tipologji të reja dhe të vjetra sa vetë Dukagjini tamam si një eksplorues i vëmendshëm.

E treta: Puna e gjatë në vite dhe dekada, me përkushtimin e dashurinë e prindit për fëmijën a të fëmijës për prindin, erdhi edhe koha që, ditët e lodhshme në terren, netët pa gjumë, muajt e vitet duke shkruar, hulumtuar, krahasuar, përpunuar dhe interpretuar, gjetjet e jetës materiale e shpirtërore, do të kurorëzoheshin dhe konkretizoheshin me një seri veprash, jo vetëm gjetje të panjohura, por edhe me studime e krijime të denja për t'u krahasuar me secilin nga kolegët bashkëkohës, a të mëparshëm.

E katërta: Botimi i një seri veprash, dhe në disa fusha, tregon se, kemi të bëjmë me një personalitet të formuar, të angazhuar dhe të përgjegjshëm për synimet që i kishte vënë vetes në dobi të historisë, kulturës dhe vlerave të Dukagjinit dhe

rëndësinë aktuale dhe për të ardhmen.

Vepra të tjera studimore të Luigj Shytit, janë: "Historik i armimit dhe kulturës në Dukagjin në 100-vjetorin e tij 1917-2017" dhe të tjera: "Fjalë të rralla, fjalë të urta", "Shprehje popullore në Dukagjin" dhe "Dukagjini më 2012" (me bashkautor) janë vepra me rëndësi të veçantë dhe të realizuara, ashtu si të parat, me kërkesa dhe kritere shkencore të pranueshme dhe bashkëkohore. Në veprën studimore "Dukagjini 2012", autori, e fillon me shënimin: "Ua kushtojmë tërë dukagjinave, si një pengesë në rrugën e harresës". Ky shënim më duket domethënëse, por edhe shumë prekës. Kjo për faktin, sepse, harresa e historisë, e së kaluarës, e vlerave tona, është si në prelude i vdekjes, ose e ngjashme me të. Për këtë arsye, si duket autorët, kërkojnë që të "vritet" harresa, të përtëritet dhe të mësohet historia, që brezat e ardhshëm të mos mbeten anonim me vlerat e veta, të paraardhësve të vet. Kjo, edhe për fatin tjetër tragjik, se, Dukagjini, ashtu si i tërë vendi ynë, ka filluar të boshatiset, largime



# Fundjava, që më krijoi kënaqësi shpirtërore, nuk harrohet kurrë

- Reportazh -

Fundjava e datës 29 tetor 2023 do ngelet gjate, shumë gjate në kujtesën time, për shumë gjera të bukura, por mbi të gjitha, për veprimet njerëzore kur ato plotësojnë në tërësi respektin e kënaqësinë familjare.

U ndjeva tejet i gëzuar, kur dy dite më parë, vajza ime Drita, dy nipat Arlindi, Mitari, me nuset e tyre e dhëndri Rexhepi, më paralajmëruan për fundjavën e së dielës, për vizitë të Kështjellës së Shkodrës, Shkodrës, Shirokës, disa vendeve buzë Bunës, bukuri të cilat (disa), nuk mu kishte dhënë rastin t'i vizitoj. Pranova ftesën me kënaqësi dhe se bashku me bashkëshorten, mblodhëm forcat, u përgatitëm për një rrugë, afër 400 km vajtje e kthim.

Mëngjesin e datës 29 tetor 2023 me dy vetura, morëm rrugë në drejtim të Shkodrës legjendare. Leqet rrugës së kombit makina e Lindit i përpinte padiktueshëm. Ato pamje të bukura vjeshtore, mëngjesin e djeshëm, shkëlqenin nga xixat e nxeheje të thella të tokës shqiptare, pasi mbi to, dielli i paradites kishte shpërndarë rrezet për mrekulli. Ndieja kënaqësi kur shikoja rrugën e kombit me shumë vetura të Kosovës, duke u futur në trojet e mëmës Shqipëri, për të shijuar bukuritë e saja te pasosura. Në Milot ndaheshin degëzimet e dëshirave...

Te Kështjella e Shkodrës (Rozafa) mbërritëm rreth orës 11,30. U ngjitem asaj lartësie përmes një rruge kalldrëmore dhe ndalem para hyrjes në pjesët e Kështjellës. Nipi, dr. Herolindi, preu dhjet bileta për gjithë sa ishim, por mirësjellja e punëtorit në sportel, për dy të moshuarit, nuk pagoi. Janë të vjetër- tha, nuk ka nevojë pagesa për këta të moshuar.

Nga hyrja në këtë tempull të historisë sonë, filloi kërsheia e ndjenjës fisnike, për të ditur atë histori shekullore të dheut e atdheut tonë nëpër shekuj, shpesh të fshehur nën dhe e mbi dhe realiteti i tij... Çdo skutë e atij tempulli të zgjonte kërshejinë për të ditur shumë e shumë gjëra të paditura. Më e papëlqyera aty, vërehej mungesa e disa ciceronëve për të plotësuar të paditurat e vizitorëve të shumtë.

Rreth orës 14-të, pas shumë fotove të bukura, lamë Kështjellën dhe "mësymë" Shkodrën legjendare. Në Shkodër isha më parë, vetëm njëherë, në kohë të eksodit, kërkoja një mikun tim kosovar.

Kafeja dhe picat në Shkodër ishin relaksimi i ditës, ishte kënaqësia e bukurisë së atij qytetit historik ku kultura jonë kombëtare i ka rrënjët e thella e të përjetshme. Pastërtia e qendrës së Shkodrës të lente përshtypjen e kulturës së njerëzve të atij qyteti. Dy tempujt fetar, afër njëri tjetrit reflektonin bukurinë e harmonisë ndërjetare. Mu soll në kujtesë miqësia e të madhit Gjergj Fishta e hoxhës së Shkodrës, kur të premtëve llafosnin së bashku në xhami, e të dielave ishin të pandarë në kishë. Shpejtë kaloi koha e qëndrimit në këtë qytet emërmadh në trojet tona. Më

mbeti koka me shikim prapa, duke shikuar gjithë atë mrekulli, por koha ecte, kishim edhe synime tjera...

E si ta përshkruaj Shirokën? ... Kush mund ta përshkruaj gjithë atë bukuri për një kohë aq të shkurtër? ... Shirokën e Filipit të madh, poetit të vargut melanko-

vend as për nga një kafe në Shirokë! ... Ishte kohë dreke. Nuk mund t'u shërbejmë shpejtë, duhet të prisni mbi një orë-na thanë dy kamerier. U tërhoqëm nga pushimi aty.

Syri i aparatit tim zuri pamje të bukura të sipërfaqes së liqenit, atyre kodrave për-

nga mrekullitë e Shirokës. Orës iu sillnin akrepat pa dëshirën time... Dielli filloi ta fsheh nën hije qytetin. Te "Mrizi i Zanave" ishte paraparë darka. Na duhet të nisemi gjyshi, me tha nipi, dr. Herolindi. Do vijmë përsëri, të shpresojmë!...



Kështjella Shkodrës, Tahiri në mes, me vajzën Dritën dhe dhëndrin, Nexhmir Rexhepi




Pamje e Shkodres, shihenn familjaret, duke shetituar qendres së ketij qyteti të bukur

lik, rilindasit të kulturës sonë letrare e jo vetëm. Nga vizitorët e shumtë, nuk gjetëm

reth, bukuri mahnitëse. Më "mbeti" zemëra aty, nuk dëshiroja të lëvizë, isha dehur

# Kelmendi...dritë - hije me refleksione të Rush Dragut, vjen si një refleksion letrar të pasurojë historiografinë shqiptare

Në tetorin e letërsisë, lexuesit shqiptar patën rastin të njihen me shumë botime të zhanreve të ndryshme, duke filluar nga botimet poetike, deri tek ato shkencore, të poetëve, shkrimtarëve dhe studiuesve të afirmuar shqiptar. Falë kontakteve të punës dhe studimeve të thelluara, kam marrë me dhjetëra ftesa për t'u bërë pjesë e prezantimit të këtyre librave, të cilat dita ditës po pasurojnë fondin e librarive të shkruar, në letërsinë shqiptare. Nisur nga fusha studimore që studioj, një vëmendje të shtuar për mua kanë pasur ato me baza shkencore, të cilat klasifikohen si burime të Historiografisë Shqiptare, ndër të cilat do të veçoj "Kelmendi...dritë hije" (refleksione), të autorit Rush Dragu, i prezantuar për publikun me datë 28. 10. 2023, në sallën e konferencave pranë Hotel Rozafës në Shkodër. Në prezantimin e këtij libri pata nderin të jem pjesë e foltores, për të mbajtur edhe një kumtesë, lidhur me këtë dorëshkrim të pasur me fakte e dëshmi historike dhe të dhëna të rëndësishme kulturore, gjë për të cilën dua të falënderoj autorin dhe



gazetaren Kozeta Bruçi, organizatorë të kësaj veprimtarie letrare, për ftesën dhe vlerësimin. Falë respektit dhe kontributit të z. Rush Dragu në vite, në jetën politike, sociale e kulturore në Kelmend e më gjerë, pjesëmarrja e publikut ishte e jashtëzakonshme, aq sa mund të quhet ndër të rrallat sa i takon këtyre veprimtarive. Libri "Kelmendi...dritë hije" me refleksione të Rush Dragut, mbart një vlerë të shtuar për krahinën e Kelmendit, por edhe për vetë autorin, pasi në të përmbledhet puna e 25 viteve, hulumtim dhe përkushtim, në studime të thelluara, për të mbledhur materiale të rëndësishme veçantë, që lidhen me Kelmendin dhe kelmendasit, në kohë e në hapësirë. Ky punim ka veçori dalluese jo vetëm për nga përmbajtja, por edhe nga metodika dhe didaktika e përdorur në hartimin e këtij teksti. E gjithë përmbajtja e tij shtrihet në 15 kapituj dhe në rreth 80 nënkapituj, ku lexuesi do të njihet me një kronologji faktesh his-

torike, të cilat datojnë që nga antikiteti e deri në ditët tona. Në këtë libër, lexuesi në mënyrë të tërthortë, do të njihet edhe me kontributin e z. Rush Dragu, pasi një pjesë e këtyre ngjarjeve lidhen me veprimtarinë e tij në Kelmend, vite më parë, çka e ka favorizuar për të pasur gjithë këtë panoramë të pasur mbi vlerat dhe të vërtetat e kësaj treve të memorizuar në kujtesën kolektive të malësorëve kelmendas dhe frëngjinjëve shekullor të kullave alpine, në votrat e të cilave u përkunden djepa kreshnikësh, kudo në Bjeshkëve të Kelmendit. "Kelmendin...dritë hije" me refleksione të Rush Dragut, guxoj ta quaj libër shkencor, për faktin se ky studim është mbështetur mbi një bibliografi të pasur me referenca, ndër të cilat mund të veçoj buletinet shkencore, si Kuntari i Muzeut Popullor në Shkodër, nr. 2 dhe 5, Kanuni i Lek Dukagjinit, Historia e Shqipërisë - vëllimi i dytë, Brenga e Ballkanit e Durhamit, Kultura Popullore, Kryengritja e Malësisë së Madhe e Romeo Gurakuqit, Fiset Shqiptare të Robert Elsie e të tjerë, të cilat janë një vullë e qartë e punës kërkimore të autorit. Bibliografia e pasur me 30 referenca, bën që ky libër të dominojë si punë kërkimore shkencore ndaj ngjarje dhe fakte të mbështetura mbi trashëgiminë gojore, apo gojëdhëna folklorike të mbledhura në terren. Nga ana tjetër ky libër merr karakter referues për secilin studiues, që punën e vet shkencore e ka të orientuar mbi këtë krahinë apo lokalitet. Në mungesë të referencave për kërkime specifike, fare mirë studiuesi mund të mbështetet tek ky libër, duke përdorur metodën e krahasimit, sidomos në rastet kur nevojiten të dhëna të përafërta, sikurse ato që lidhen me folklorin, traditat dhe ngjarje historike. Gjithashtu ky libër i mbështetur mbi gjithë këtë literaturë, si dhe burime institucionale shtetërore, dëshmon për një përmbajtje të pasur me dëshmi të sakta arkivore, të cilat për secilin kelmendas që përmendet në mënyrë direkt apo indirekte në këtë libër, mund të ruhet si një pasuri shpirtërore dhe t'u trashëgohet brezave. Me një vlerësim dhe konsideratë të lartë për autorin dhe punën e tij, ftoj lexuesit ta lexojnë dhe ta vlerësojnë këtë punë të çmuar të autorit malësor Rush Dragu. "Kelmendi...dritë hije" me refleksione të z. Rush Dragu, në këtë tetor të letërsisë së Shqipërisë, përmbushi me dinjitet edhe dritë hijet e letërsisë në Malësi të Madhe, ndaj me shumë konsideratë në emrin tim dhe të ACTV - NY i urojmë shumë suksese në punën dhe aktivitetin e tij mediatiqe si një përçues i denjë i vlerave tona kulturore kombëtare.

Nga Rita Shkurtaj  
Nëntor 2023



# Pashko Camaj - intelektual e mësimdhënës i talentuar

Nëse ka pasur ndonjë të mirë sistemi i kaluar një partiak, ajo ka qenë zhvillimi, masivizimi dhe cilësia e shkollës. Në këtë drejtim është përfshirë edhe Dukagjini, duke pasur një hop cilësor e sasior në zhvillimin e arsimit. Pa mohuar kontributin e arsimtarëve jabanxhinj, meritë kryesore kanë pasur mësuesit vendas, që një ndër më të shquarit ka qenë Pashko Camaj, për të cilin do të shkruajmë më poshtë.

Pashko Camaj, u lind në mars të vitit 1951, në një familje zëmadhe të krahinës së Shalës- Dukagjinit, nga dy prind fjalëpakë e pune shumë -Ndue Cama e Leze Lulja (bijë nga Shoshi). Shkollën fillore e 7 vjeçare i kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen pedagogjike "Shejnaze Juka" në Shkodër, në vitin 1970, me rezultate te larta dhe filloj rrugëtimin e gjatë të mësimdhënësit. Që në fillimet e para të mësimdhënësit të tij shfaqti aftësi të veçanta dhe dëshirë të madhe për dije, përvetësonte më mirë se bashkëmohatarët dijet shkencore, që në këtë drejtim bënte diferencën. Tabelat e nderit "u mërzi të" me Te, sepse ishte i përhershmi aty. I etur për dije, kërkues ndaj vetes, me dëshirën e madhe për të shtuar aftësitë e tij shkencore e pedagogjike si mësimdhënës, në kushte shumë të vështira e mundësi të pakta, sepse mbeti jetim nga baba shumë herët, pa u bërë mësues, vijoi Universitetin e Tiranës pa shpëtim nga puna, të cilin e përfundoi për një kohë rekord në vitin 1979, me rezultate shumë të mira, dega gjuhë- letërsi.

Në vitet 1971 - 1972 kreu shërbimin e detyrueshëm ushtarak në Fier. Shtrirja e shkollave, në të cilat Pashku dha mësim, është e gjerë, por fatmirësisht vetëm në krahinën e Shalës, duke u treguar diçka zemërgjerë politika e kuadrit, duke marrë parasysh nevojat e tij familjare.

E filloj punën në shkollën 8 vjeçare Breglumi, në të cilën u rikthye pas disa viteve qarkullim në shkollat të ndryshme të krahinës: shumë vite në Lotaj, disa vite në Abat, drejtor në shkollën 8 vjeçare në Gimaj e të tjera. Si shumë të tjerë, në vitin 2000 Pashku u largua nga vendlindja dhe u vendos në Shkodër, për një jetë më të mirë. Shumë vite punoi në Malësinë e Madhe, në detyrën e drejtorit të shkollës në Kamicë dhe mësues në shkollat 9 vjeçare dhe të mesme në Koplik deri sa doli në pension.

Pashkun e kam njohur nga afër, që në hapat e para të shkollimit dhe në punë në detyrën e shenjtes të mësimdhënësit, që pata fatin të jem kolegj me të në shkollën Lotaj. Na bënte përshtypje fjala e tij e ngrohtë dhe miqësia e sinqertë, kultura e gjerë, veprimtaria e tij plot vull e intensitet. Ishte shumë vital.

Për 45 vjet punoj mes nxënësve në detyrën e mësimdhënësit dhe drejtues në shkollat të ndryshme pa e ndër lodhjen e mërzi. Gjatë gjithë punës, që në hapat e para e në vijim, në detyrën e mësuesit tregonte, që e donte shkollën, profesionin e mësuesit dhe çdo ditë cilësia e pu-

nës së tij kishte progres. çdo ditë e më tepër bënte përpjekje serioze për ta përfeksionuar artin e mësuesit. Pashku ishte shumë studiues, duke shtuar aftësitë e tij shkencore e metodik, përdorte në orën e mësimi metoda bashkëkohore mësimdhënie, duke përkrah metodat e reja e shmangut ato tradicionale. Nxënësit nuk i konsideronte si objekt, por si subjekt i mësimi e bashkëpunues të afërt të punës për krijimin e dijeve sa më të qëndrueshme e përgatitjen e tyre për jetën. Pikërisht këtu qëndronte edhe çelësi i sukseseve në procesin mësimor- edukativ që arriti në vijimësi në detyrën e mësuesit dhe të drejtuesit të shkollës. Ishte i veçantë në cilësinë e shkrimit sipas të gjitha rregullave drejtshkrimore, i cili



bënte përpjekje të vijueshme me jua kultivua edhe nxënësve, ishte shumë kërkues në këtë drejtim.

Në personalitetin e Pashkut harmonizohen më së miri: njeriu i devotshëm me qytetarin e përgjegjshëm, intelektualin krijues, me pasionin për dijen dhe shkencën, edukatori e mësimdhënës i përkushtuar me studiuesin sistematik e prodhimtar, gërshtimi i vetive e virtuteve më të mira të origjinës që i qëndrojnë kohës me edukatën qytetare të fituar në shkollë dhe shkollën e jetës si dhe jetën urbane. Sa i dashur, i respektuar e bashkëpunues me kolegj, nxënës e prind, aq ishte i papajtueshëm me të metat e dobësitë që vrenjtje, duke qenë shumë kritik e asnjë herë konformist. Me punën e tij kudo që ka

punuar ka fituar respektin e bashkësisë së nxënësve e prindërve, të cilët edhe sot të flasin fjalët më të mira. Në detyrën e mësuesit dhe e drejtuesit nuk merrej me "vogëlsira", por primare kishte problemet e përmbytjes. Ishte sistematik në përgatitjen ditore e atë afatgjatë, duke rritë gjithnjë rendimentin e orës së mësimi dhe cilësinë e asimilimit të dijeve nga nxënësit, duke mos pas analfabet funksional siç ka sot me shumicë. Ishte artist e novator në dhënie e mësimi. Në një orë mësimi në letërsi, duke u vëzhguar nga drejtori më i paafët se ky, të vetmen vërejtje që i bëri ishte: "E dramatizove tepër orën e mësimi, sepse nxënësit mbetën si të hutuar!" Gjithnjë punën e tij e mbështete në binomin mësim dhe

krijues dhe interpretues. Ka qenë shumë mbresëlënëse interpretimi i rolit të Balës në dramën "Shpartallimi" të dramaturgut Fadil Kraja, vënë në skenë nga shtëpia e kulturës Breglumi, rol i cili u vlerësua shumë nga spektatori dukagjinasi e më gjërë.

Pashku është jo vetëm intelektual e mësimdhënës i talentuar, por edhe një prind shembullor. Bashkë me bashkëshorten Marie nga Palçi i Mërturit, lindën, rritën, edukuan dhe shkolluan tre fëmijë të mrekullueshëm: Bardhin, Valbonën dhe Dashamirin, të cilët sot vijojnë jetën e tyre shumë të suksesshme në Evropë dhe Amerikë.

Pashku ka pas e ka edhe një dhunti tjetër, të cilën pak kush nga kolegët e ka pas, ka qenë dhe është mjeshtër shumë i mirë i gurit e sidomos i drurit. Këtë "profesion" e ka ushtruar në shtëpinë e vet i nxitur nga nevoja si i vetëm në familjen e tij, i cili ka ndërtuar shtëpia model në vendlindje e në vendbanimin e ri në Shkodër, që të bien në sy sidomos punimet e drurit. Pra, është nga ata që çfarë i shfaq syri ja bën dora. E quajti domosdoshmëri dhe e priti me sportivitet ndryshimin e sistemit nga ai monist në demokratik, por nuk ishte dakord dhe ishte shumë kritik ndaj shumë plagëve që hapi sistemi i ri, të cilat humbën shumë vlerat e njeriut dhe të familjes. Edhe sot është shumë aktiv edhe pse është në moshën e tretë. Lexon shumë, lëviz pareshtur, merr pjesë në të gjitha veprimtaritë që organizon shoqata Atdhetare "Dukagjini", anëtar i së cilës është prej vitesh, si dhe merr pjesë në promovime libri apo në veprimtaritë kulturore e artistike që zhvillohen.

Për punën e tij të palodhur kudo ku ka punuar, ka marrë vlerësimet maksimale nga bashkësia dhe është vlerësuar edhe nga pushteti qendror e vendor. Në vitet 80 të shekullit të kaluar është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor i kohës me urdhëron "Naim Frashri".

Shoqata Atdhetare "Dukagjini", në kudër të 100 vjetorit të arsimit në Dukagjin e ka nderuar me titullin "100 vjet arsim e kulture në Dukagjin", me motivacionin: "Për devocion e përkushtim të përhershëm në fushën e arsimit dhe ngritjes së nivelit kulturor të bashkësisë Dukagjinase". Edhe bashkia e Koplikut i ka dhënë medaljen e mirënjohjes për rezultate të larta në fushën e arsimit dhe edukimit në Malësinë e Madhe.

Paraqitëm shkurtimisht copëza nga jeta dhe veprimtaria e intelektualit dhe mësimdhënësit të talentuar Pashko Camaj, dhe i mbyllim këta rreshta, duke i uruar pleqëri të mbarë me shëndet të plotë, zemër plot dhe ta kemi midis nesh edhe shumë dekada aktiv e vital si deri më sot.

**PRELË SHYTANI,**  
Shkodër, nëntor 2023

edukim. Sipas tij nxënësi duhet të jetë në radhë të parë njeri, me sjellje dhe edukatë të shëndoshë, që për arritjen e këtij objekti në çdo kohë kërkonte ndihmën e prindërve duke bashkëpunuar ngushtë me ta, duke përdorur me nxënësit metodën e bindjes larg tutelës e pedantizmit.

Pashku ka qenë dhe është mik i librit, shumë i pasionuar pas leximit duke gjetur tek ai zbatim shprehja se një libër të hap një dritare me pa jetën. Kjo ka ndikuar që të kenë një horizont e formim intelektual shumë të gjerë. Edhe sot ka një bibliotekë shumë të pasur dhe çdo ditë e gjen me një libër në dorë. Ka qenë shumë aktiv në veprimtaritë jashtëshkollore, duke marrë pjesë rregullisht në veprimtaritë artistike dhe kulturore, që zhvilloheshin si

\*\*\* POEZI nga Çesk Lukani \*\*\* POEZI nga Çesk Lukani \*\*\*

**GJYSHES**

Gjyshja ime bëre për mellë,  
teksa mbushte ujë në krua.  
Kur zinte hall i madh  
kërkonte ndonjë gjë hua.

Nuk e kishte zakon e shkreta,  
por nga dertet e mëdha,  
aq e rrudhur ish kuleta ,  
s'mbyllej muaji me para.

Si shumë shoqe të seres sonë,  
ishte e matur ne çdo fjale .  
Thoshte shpesh kur bosh premtinin:  
-Peshku ne dete, tigani ne zjarr.

Ç' do gjë shume ka ndryshuar  
qe nga koha e gjyshes sime .  
Seç mu dha për ta kujtuar ,  
Jeta e saje me pak gëzime.

Tani prind jam dhe unë vete,  
Fëmijërinë time qaj me lote,  
kohe e ikur e kësaj jete ,  
kohe e gjyshes qe shkoi kot.

Ne mendim po për mallohem ,  
ç' qe për mua ky vegim?  
Lutem nënat te nderohen  
N' ketë jete e në amshim .

**E RUAJ RADION**

Tash radioja s'po dëgjohet ma.  
Une e ruaj për kujtim,  
ka sillem sytë lëshoj me e pa,  
si kohen ne për mallim.

Mungonte luksi nder ne  
dijen vrapofshim me nxënë,  
në zemër dashnin për Atdhe  
E kishte dhe fëmija moj nanë.

Liria e lame me lot,  
rraje ka leshu mes nesh.  
Filizat e lindur ka mot,  
veç në ëndërr mund ti gjesh.

Une radion e ruaj për kujtim,  
relike para ardhëse e se rese.  
Nëse dikush lutet me guxim,  
për euro e dollarë nuk ua shes.

**GJENERAL PETRIT ÇUNIT**

Kur dëgjoj për Dukagjinin,  
krahasimin baj me florinin.  
Petrit Çuni emri tij,  
lind e rrit për ketë Shqipni .

Në Malësi e lëshoj shtatin ,  
deri ditën qe pa sahatin.  
Ai sahat për te qe shkrua,  
Skënderbegas me fillua .



Neper shkolla e Akademi  
e msoi artin per ushtri  
se burrnin e ka n'gjak  
punetor fort e fjale aspak .

Me punu per mëmëdhene,  
nderon vendin e Skenderbene .  
Nderon fis , nderon flamur,  
nderon baben qe e rriti burre .

Nderon nanen qe i dha gji ,  
tash nderon mbare një Shqipni .  
Kombi ty tash të thretet ,  
me ja ruajt besen e vet.

Se ky djale ka guxim  
e din shqipja ku ka trimin .  
Ska armik qe i dridh qerpikun ,  
sfidon t'keqen e rrezikun .

Mbi 50 vjet nana priti djalin,  
me i pa ne supe "Gjeneralin" ,  
doren vuni mbi flamure,  
e dha besen si një burre .

Ne Europe ka ik fjala ,  
Gjeneral ka rrite Shala .  
Bajne me dite ka ba bene  
me ruajt besen per Atdhene .

Tash te nderon kombi mbarë  
ne etni ku ka Shqiptare .  
Ne kto troje qe tujat jane ,  
na u ban roje ane e mbane .

**DO TË GËZOHESH HANE**

O Hane, gjyse u bane  
A s'me thu cfare po mendon  
Nji deshire kam për zonjen tande  
Vendin tim kur ma shikjon.

Ne ate vend lulzon pranvera,  
uji i ftohte buron prej malit.  
Bukuri s'ka nshoqe tjera,  
ku fellanxa i kendon djalit

Ai dallon nga dhena tjera  
Perendite e kane krijua,  
Çdo shtegtar ndalet perhera  
Trup e shpirt per me i pushu.

A sheh Hane lumej e dete?  
Mbushin vendin plot freski  
Merr shkelqim dhe ti për vete  
Kur t'kalosh permby Shqipni.

Une kyt nate do t'pres agimin,  
larg Atdheut i permallum.  
Kur ta shoh ma shum shkelqimin,  
Do t'kujtoj ate vend tbekum.

Do t'kujtoj rinine e shkume,  
qe shetitem ane e mbane.  
Ne cdo vend me gezim lodrume  
Gjithkah vendit kah i rame.  
Ndalun drites kur tlargohesh  
Do ule shtatin te pushoj

Dhe ti vetes do ti gezohesh  
Per kyt vend qe te ndricoj.

**MEDITOJ**

Gjumi s'po m'nxen ty tuj t'mendu.  
E kur ban me m'nxan m'del n'anderr.  
Ne vitet mbi shpine kohe ka shku  
prej diteve tbukura qe ishim zhgjanderr.

Diten kenaqem me kangen e zogjve.  
Mpelqen sa amel cicerojne,  
nigjoj me andje kanget e mocme  
e shoh se gjithmon njelloj dashurojne.

**HERET U ZGJOVA SOT**

Heret u zgjova per Shen Valentin.  
Femijet perqafova me rradhe,  
secili ne sy kishte gezim  
Kur nenen ua putha ne balle.

E vogla lule kishte mbledhur,  
secilit na i solli ne dore,  
e madhja me nga nje varg te hedhur  
Ne qafe na i vuri kurore.

Djali vështroi buzagaz,  
-Dukeni si sot te martuar.  
Dy pellumba leshoj mbi pullaz,  
te dy Gu Gu te dashuruar.

**LEMZA E NANES**

Ne anderr te bukur nji nate lume,  
prej se lodhunit gjumit rane,  
flet me vedi gjys zbulume,  
ndihet zani ku je nane.

Viti pare kishte kalu.  
Perbri ngjitet femija n'djep,  
ne are gjith ditën tuj punu  
S'pat e ngrata ç'fare i jep.

Lemza fort e merr nanen.  
Anderra e vajz gjumin ja qet.  
Del n'dritare e sheh hanen,  
ban nji lutje tshpirtit vet.

Ti moj hane qe shdrit mbi dhe,  
e lshon rreze ane e mbane,  
bani dije bijes sime.  
Thuj jam larg per ty moj nane

Hana nans ja merr merzine  
Lutja vjen duke e nxane,  
plot me re qiellin e nxin.  
E leshon gjamen n'tjeter ane.

Bija nuse ngriti shtatin,  
e tund djepin kadal me dore.  
Kujton andrren, sheh sahatin  
Nanat gjitha jane me Ore.

**REDAKSIA**

Kryeredaktore: Klodjana Serraj  
Luigj Shyti, Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,  
Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia Dushi, Leke Sokoli,  
Edmond Tërthorja, Lulash Brigja, Vilson Peshkaj, Prele Shytani,  
Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:  
**MARK RUPA**

